

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5578  
E hënë, 17 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

## Korrigjimi paqësor i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

FAQE 11

Shkruan:  
Hashim  
THAÇI



FLET PËR  
"EPOKËN E RE",  
ENVER HOXHAJ

FAQE 4-5



## Këtë vit përparësi duhet të ketë dialogu, jo zgjedhjet e reja

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka vlerësuar se aktualisht në Kosovë gjërat nuk janë duke shkuar në drejtimin e duhur. Ai ka thënë se për këtë përgjegjësinë e mbajnë pozita dhe opozita. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka thënë se partnerët e koalicionit dhe

opozita duhet ta përfundojnë procesin e shtetndërtimit dhe kompletimin e sovranitetit të Kosovës. Ai ka bërë me dije se është koha e fundit për arritjen e konsensusit politik për dialogun, duke bërë thirrje që elita politike të silltet me përgjegjësi shtetërore. Hoxhaj ka vlerësuar se këtë

vit përparësi duhet të ketë dialogu e jo zgjedhjet e reja. Sipas tij, përderisa Kosova është në proces të dialogut nuk duhet të ketë zgjedhje. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se nuk do të lejohet që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të ketë karakter ekzekutiv dhe territorial

## Duhet të rritet llogaridhënia në të gjitha ndërmarrjet publike

FAQE 8-9

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, ka thënë se është çasti i fundit kur kryesuesit e Ndërmarrjeve Publike (NP) në vend duhet të reflektojnë karshi obligimeve ligjore. Në një intervistë për gazetën "Epokën e re" ajo ka thënë se këto ndërmarrje duhet të jenë në trend me zhvillimet e tregut dhe konkurrencën e lirë. Ndërsa duke iu referuar zhvillimeve të fundit në Postën e Kosovës, ajo ka thënë se do të duhej të ndodhte nivelimi i pagave në këtë ndërmarrje. Kurse sa i përket zvarritjes së draftstatutit të "Trepçës", Berisha-Shala ka thënë se ka interferime politike në këtë drejtim



### Kosova po bën përgatitjet për anëtarësim në Interpol

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### POLLATA LEGJENDARE F.13

Ismet SYLEJMANI



#### LOBI I GRAVE TË RAJONIT TË EVROPËS JUGLINDORE KUNDËR NDRYSHIMIT TË KUFIJVE F.7

#### SERBËT I MBESIN BESNIK BEOGRADIT, POR MARRIN PARA EDHE NGA PRISHTINA F.6

#### VESELI VIZITOI AMBIENTIN KU 20 VJET MË PARË U THEMELUA SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-së F.2

#### SHPËTIM IDRIZI BRAKTIS RAMËN, PDIU NË KOALICION ME BASHËN F.2

### EKONOMI

#### KOSOVA I SHKRUAN LETËR SHQIPËRISË PËR TAKSËN PËR 'RRUGËN E KOMBIT' F.9

### KULTURË

#### TRIMAT E POLLATËS JANË PJESË E LIRISË SONË KOMBËTARE F.13



Prof. dr. Nusret PLLANA

### SPORT

#### FLAMURTARI 'VALON' EDHE NË STADIUMIN 'ZAHIR PAJAZITI' F.20

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Zaevi: Maqedonasit duhet të pranojnë emrin e ri ose të përballen me izolim

SHKUP, 16 SHTATOR - Kryeministri maqedonas, Zoran Zaev, ka thënë se qytetarët duhet të pajtohen ta pranojnë emrin e ri të shtetit ose do të përballen me jostabilitet dhe izolim. Në një intervistë për agjencinë "AFP", Zaev ka kërkuar nga maqedonasit të votojnë pozitivisht në referendumin që do ta vendosë

riemërimin e vendit me emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut". Referendumi do të mbahet më 30 shtator si rezultat i marrëveshjes së aritur në mes të Maqedonisë dhe Greqisë për t'i dhënë fund çështjes së emrit pas shumë dekadave. Çështja e emrit në mes të Shkupit

dhe Athinës daton që nga viti 1991, kur Maqedonia u nda nga Jugosllavia dhe deklaroi pavarësinë nën emrin Republika e Maqedonisë. Greqia nuk është pajtuar me emrin Maqedonia për shkak se, sipas saj, përfshin territorin e veriut të Greqisë me emrin e njëjtë. Për shkak të kundërshtimeve greke,

Maqedonia është pranuar në Kombet e Bashkuara me një emër të përkohshëm Republika e ish-Jugosllavisë, Maqedonia. Greqia, anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, kishte deklaruar se mund të ketë veto në rast të planit për anëtarësim të Maqedonisë në këto dy organizata.




## Mediu në takim me Haradinajn: Dialogu me Serbinë t'i garantojë kufijtë e Kosovës

Kryetari i Partisë Republikane të Shqipërisë, Fatmir Mediu, në takim me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të finalizohet me njohjen e Kosovës dhe garantimin e integritetit territorial dhe kufijve të saj

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Republikane të Shqipërisë, Fatmir Mediu, është takuar në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilin ka biseduar për dialogun me Serbinë dhe për çështjen e integritetit euroatlantik të Kosovës. Mediu ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të finalizohet me njohjen e Kosovës dhe garantimin e integritetit territorial të vendit tonë. "Dialogu me Serbinë duhet ta finalizojë njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe garantimin e integritetit të territorit dhe kufijve të Kosovës. Ndërtimi i një shteti demokratik funksional në Kosovë është parakusht për të ardhmen e saj,

në partneritet me ShBA-në dhe BE-në, duke shmangur çdo lloj ndërhyrje nga vende të tjera të cilat janë kundër të ardhmes euroatlantike të Kosovës", ka shkruar Mediu në logarinë e vet në "Facebook". Ai ka paralajmëruar se kryeministri Haradinaj në fund të këtij muaji do të ketë një vizitë në ShBA. "Vizita në fund të shtatorit në ShBA, Nju Jork dhe Uashington DC, e kryeministrit Haradinaj, do t'i shërbejë këtij qëllimi dhe forcimit të marrëdhënieve me ShBA-në. Ndërtimi i Ushtrisë së Kosovës si një forcë e armatosur që e ka të ardhmen në NATO është një hap i rëndësishëm për konsolidimin e shtetit të pavarur të Kosovës", ka shkruar Mediu.



## Basha: Shqiptarët në Maqedoni të votojnë pro referendumit

SHKUP, 16 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zhvilluar takime me faktorin politik në Maqedoni, ku ka bërë thirrje për të votuar në mbështetje të referendumit për emrin që do të mbahet më 30 shtator. Në përfundim të takimit me kreun e Bashkimit Demokratik për Integritim, Ali Ahmeti, Basha tha se vota pro referendumit është votë për të ardhmen e Maqedonisë euroatlantike. "Jam këtu që në emër të Partisë Demokratike t'i mbështes dhe të përgëzoj nga zemra përpjekjet e palodhura të liderit shqiptar, të Ali Ahmetit, të kolegëve të tij, krahu për krahu



edhe forcave të tjera politike të Maqedonisë, që më 30 shtator të shënohet një kapitull i rëndësishëm për Maqedoninë, por edhe për mbarë rajonin, duke hedhur hapin vendimtar drejt

anëtarësimit të Maqedonisë në NATO. Partia Demokratike ka një porosi apo një keshillë, një mesazh për të gjithë qytetarët e Maqedonisë, në veçanti për bashkëkombësit tanë shqiptarë,

të dalin masivisht e të marrin pjesë masivisht të gjithë në referendumin e 30 shtatorit dhe ta hedhin votën e tyre për Maqedoninë në NATO dhe për të ardhmen e sigurt euroatlantike dhe evropiane të Maqedonisë dhe mbarë rajonit", u shpreh Basha.

Ndërsa kreu i BDI-së, Ahmeti, tha se vota e 30 shtatorit është një moment historik për Maqedoninë. "Është një moment historik që nuk përsëritet dhe tërësisht për këtë angazhim Basha na dha përkrahjen e fortë që ne të vazhdojmë me përkushtim që vendi ynë të jetë anëtar i plotë në NATO, të

jetë anëtar i plotë në Bashkimin Evropian. Më 30 shtator vendoset jo vetëm për një Maqedoni stabile, por për një rajon shumë më të sigurt, si për popujt që jetojnë këtu, ashtu edhe për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Prandaj do të doja ta falënderoja nga zemra mikun tim Lulzim Bashën për këtë përkrahje kaq të sinqertë që po ua jep jo vetëm shqiptarëve, por të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë sepse 30 shtatori është paqja, stabiliteti, siguria, ardhmëria, marrëdhënia me fqinjët, janë në dobi të të gjithëve dhe nga paqja fitojmë të gjithë", tha Ali Ahmeti.

## Shpëtim Idrizi braktis Ramën, PDIU në koalicion me Bashën

Tiranë, 16 shtator - Partia për Drejtësi, Integritim dhe Unitet (PDIU) i është bashkuar koalicionit të Partisë Demokratike (PD). Pas takimit me kreun e PD-së, Lulzim Basha, Shpëtim Idrizi ka njoftuar për kalimin e partisë së tij në kampin opozitar. Ai ka thënë se gjatë bashkëpunimit me qeverinë

Rama nuk është bërë asgjë në lidhje me çështjen e Çamërisë. Sipas Idrizit, Rama ka treguar arrogancë për këtë çështje, duke i mohuar të drejtat shqiptarëve të Çamërisë. "PDIU sot është pjesë e opozitës së bashkuar. Përballë një mazhorance arrogante dhe ajo që është më e rënda, braktisjes së vendit nga

shqiptarët, kemi nevojë për një opozitë të fortë që ta ketë alternativën e saj për të dalë nga ky tranzicion i tejzgjatur për t'u dhënë shpresë shqiptarëve", ka thënë Idrizi. Ndërkaq kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ka thënë se subjekti politik që drejton do ta vazhdojë

angazhimin për të drejtat e shqiptarëve të Çamërisë. "Dua të ndaj këtë lajm me të gjithë shqiptarët. Pozita është në frontin më të gjerë dhe me bashkimin e fronit. Është konkluduar me sukses marrëveshja me PDIU-n. Opozita është më e fortë me bashkimin e të gjithë aktorëve. Pas takimit me PDIU ne i



shërbejmë interesit të qytetarëve. Opozita e bashkuar ka sot një mision jetik për çdo familje shqiptare", ka thënë Basha.

# Kosova po bën përgatitjet për anëtarësim në Interpol

Zyrtarët e institucioneve të Kosovës kanë shprehur optimizëm se këtë vit Kosova do të arrijë të bëhet anëtare e Interpolit. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se aktivitetet e institucioneve të Kosovës për këtë çështje janë duke u koordinuar nga grupi punues ndërintistucional. Kosova tashmë është pjesë e agjendës në takimin e radhës së Asamblesë së Përgjithshme që zhvillohet nga 18 deri më 21 nëntor 2018 në Dubai



shumë i konvenon Interpolit, meqenëse për momentin jemi vetëm konsumues të sigurisë. Po të ishim anëtarë edhe ne do të kontribuonim me informatat tona në luftimin e të gjitha dukurive negative: si atyre të migrimit ilegal, të dokumentacionit, të gjurmëve të gishtit dhe të njerëzve që janë në listat e kuqe", është shprehur Qalaj, duke shtuar se tani Kosova e ka edhe mbështetjen e nevojshme ndërkombëtare në këtë çështje. "Normalisht se jemi optimistë, sepse është punuar mjaft shumë në këtë drejtim. Kemi edhe një mbështetje nga faktori ndërkombëtar, pra nga partnerët tanë. Ende na duhet shumë punë, por besoj shumë se do të kemi sukses", ka thënë Qalaj. Vitin e kaluar Kosova pati aplikuar për anëtarësim në Interpol. Çështja e pranimit të saj ishte futur në agjendën e Komitetit Ekzekutiv të kësaj organizate, në mënyrë që të votohej për pranimin e saj në Asamblesë të Përgjithshme vjetore të kësaj organizate, e cila u mbajt më 17 shtator të vitit 2017, në Pekin. Por, nga pasiguria se do t'i siguronte votat e mjaftueshme për pranim, kishte tërhequr kandidaturën.

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 16 SHTATOR** - Institucionet e Kosovës janë duke i bërë të gjitha përgatitjet për anëtarësim në Interpol. Përfaqësuesit e MPB-së dhe të Policisë së Kosovës kanë shprehur optimizëm se në vjeshtën e këtij viti Kosova do të mund të bëhet anëtare e kësaj organizate botërore të policisë.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova tashmë është pjesë e agjendës në takimin e radhës të Asamblesë së Përgjithshme që zhvillohet nga 18 deri më 21 nën-

tor 2018 në Dubai. "Aktivitetet e institucioneve të Kosovës janë duke u koordinuar nga grupi punues ndërintistucional. Angazhimet dhe përpjekjet e institucioneve të Republikës së Kosovës janë gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara në nivelin nacional dhe me partnerët strategjikë të Republikës së Kosovës. Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare ka qenë dhe është një proces i pakthyes dhe i pandalshëm, ashtu siç është dëshmuar me anëtarësimet e deritanishme të vendit tonë në më shumë se gjashtëdhjetë organizata rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare", ka thënë Zeka.

Ai ka shtuar se procesi i anëtarësimi të Kosovës në organizata ndërkombëtare të sigurisë është në interes të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve anëtare në përgjithësi dhe i Republikës së Kosovës në veçanti. "Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare të sigurisë duhet të shihet nga të gjithë si një proces i natyrshëm dhe i domosdoshëm që do t'i kontribuojë rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar transnacional, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm", ka thënë zëvendësministri Zeka.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka shprehur optimizëm se sivjet aplikimi do të jetë i suksesshëm. Ai ka treguar se kësaj here ka një koordinim të aktiviteteve nga të gjitha institucionet për këtë çështje. "Synimi i të gjithëve është që sa më shpejt të pranohemi në Interpol dhe më vonë në Evropol. Besoj se i kemi gjasat mjaft të mira kësaj here, ani pse nuk do të jetë lehtë. Kjo rrugë ka shumë sfida. Ju me siguri jeni në dijeni për fushatën e Serbisë kundër anëtarësimi të Kosovës në institucione ndërkombëtare. Personalisht mendoj se anëtarësimi i Kosovës në Interpol më

# Veseli vizitoi ambientin ku 20 vjet më parë u themelua Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së

**SKENDERAJ, 16 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, së bashku me anëtarë të Rinisë Demokratike dhe bashkëluftëtarë të Drenicës, kanë vizituar të dielën Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Likoc të Skenderajt, ku kanë përkujtuar përpjekjet për liri dhe pavarësi. Veseli ka thënë se 20 vjet më parë të rinjtë dhe të rejtat e këtij vendi patën themeluar Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. "Para 20 vjetësh të rinj e të reja vendosen që në përpjekjen e tyre për liri dhe pavarësi, në Likoc të Skenderajt ta themelojnë Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kosovës. Pas 20 vjetësh, për ta shënuar themelimin e shtabit dhe për të kujtuar atë periudhë, njerëz që dhanë jetën në betejë, na mblodhi sërisht rinia. Me anëtarët e Rinisë Demokratike të Kosovës dhe bashkë me shumë bashkëluftëtarë e qytetarë të Drenicës ndamë përjetimet tona për atë kohë. Por, mbi të gjitha, bashkëbiseduam për të ardhmen tonë, për një jetë më të mirë për gjeneratat e reja, duke kujtuar gjithmonë të kaluarën tonë të lavdishme", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

# Këtë vit përparësi duhet të ke



Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka vlerësuar se aktualisht në Kosovë gjërat nuk janë duke shkuar në drejtimin e duhur. Ai ka thënë se për këtë përgjegjësinë e mbajnë pozita dhe opozita. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka thënë se partnerët e koalicionit dhe opozita duhet ta përfundojnë procesin e shtetndërtimit dhe kompletimin e sovranitetit të Kosovës. Ai ka bërë me dije se është koha e fundit për arritjen e konsensusit politik për dialogun, duke bërë thirrje që elita politike të silltet me përgjegjësi shtetërore. Hoxhaj ka vlerësuar se këtë vit përparësi duhet të ketë dialogu e jo zgjedhjet e reja. Sipas tij, përderisa Kosova është në proces të dialogut nuk duhet të ketë zgjedhje. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se nuk do të lejohet që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të ketë karakter ekzekutiv dhe territorial

## Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 SHTATOR -  
**"Epoka e re":** Z. Hoxhaj, si e vlerësoni funksionimin e deritanishëm të koalicionit qeverisës?

**Hoxhaj:** Koalicioni qeverisës ka arritur t'i përmbushë disa prej pritjeve që ka pasur, para së gjithash, ratifikimin e marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi si dhe vendimet që janë marrë deri më tani në Bruksel, përfshirë atë të Komisionit LIBE dhe të Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave, sikurse që ka miratuar tri projektligje sa i takon themelimit të ushtrisë së Kosovës dhe përmbylljes së tranzicionit të FSK-së. Duke

pasur parasysh këto së bashku, me shumë vendime të tjera që i kemi marrë, mund të thuhet se ka qenë një funksionim i mirë mes partnerëve të koalicionit për përmbushjen e pritjeve që ka pasur gjatë kësaj kohe, meqë këto kanë qenë temat e madha. Ndërsa nuk dua të hyj në tema të tjera të cilat janë të karakterit të qeverisjes ditore.

**"Epoka e re":** Pse gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur shtim të numrit të njohjeve dhe anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare?

**Hoxhaj:** Nuk dua të merrem me atë se sa vende do të duhej ta njohin Kosovën meqë nuk jam ministër i Jashtëm. Por, një gjë mund ta them, se

Kosova nuk duhet ta reduktojë politikën e vet të jashtme vetëm në raport me Serbinë përmes dialogut si instrument të saj. Të gjithë ne duhet të bëjmë çdo gjë që është e mundur që të sigurojmë njohje të reja, anëtarësim të Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare, forcim të marrëdhënieve bilaterale me shtete të ndryshme në botë si dhe avancim të pozicionit në raport me BE-në dhe NATO-n. Të gjitha këto janë në shërbim të ushtrimit sovraniteti dhe konsolidimit të shtetit.

**"Epoka e re":** Por opozita dhe shoqëria civile po ju quajnë qeveri të skandaleve dhe shumicën prej vendimeve po i

# të dialogu, jo zgjedhjet e reja

jnë partnerët e koalicionit dhe partitë opozitare. Prandaj, është koha e fundit që të krijojmë një konsensus politik për temën e dialogut si dhe është koha e fundit që të sillemi si një elitë politike me një përgjegjësi shtetërore, dhe përgjegjësia shtetërore nuk i takon vetëm qeverisë, por edhe opozitës.

**"Epoka e re":** Si mund të funksionojë edhe më tutje ky koalicion qeverisës apo edhe ta çojë deri në fund mandatin duke pasur parasysh se gjatë këtyre 12 muajve në Kuvend është ballafaquar me mungesë të numrave dhe në shumicën e rasteve nuk e ka pasur as shumicën e thjeshtë prej 61 votave me ç'rast, në mungesë të kuorumit, ka dështuar mbajtja e seancave.

**Hoxhaj:** Jo vetëm koalicioni qeverisës nuk i ka numrat, por as opozita nuk i ka numrat. Kemi mbetur të varur nga qëndrimi i Listës Serbe dhe kjo nuk është e shëndoshë për Kosovën as politikisht dhe as në një plan më afatgjatë. Prandaj, edhe kërkohet prej partive politike shqiptare që ta rrisin mirëkuptimin dhe bashkëpunimin që t'i ndajnë pritjet që i ka qytetari dhe aspiratat që i ndjek vendi. Meqë Lista Serbe do të silltë njëjtë në Kuvendin e Kosovës sikurse deri më tani, asgjë nuk do të ndryshojë. Prandaj, kërkohet që disa prej gjërave madhore t'i përmbyllim dhe punët që i ka koalicioni qeverisës t'i përfundojë brenda mandatit, duke siguruar mbështetjen e partnerëve të tjerë.

**"Epoka e re":** Duke pasur parasysh gjendjen në Kuvend, ka gjasa që këtë vit të shkohet në zgjedhje apo vitin tjetër, ashtu siç po flitet në opinion?

**Hoxhaj:** Si Parti Demokratike e Kosovës (PDK) mendojmë se tash dialogu duhet të ketë përparësi. Përderisa jemi në dialog nuk mendojmë se duhet të ketë zgjedhje të reja. Një elitë politike nuk mund edhe të shkojë në zgjedhje, në të njëjtën kohë të merret edhe me një temë madhore sikurse kompletimi i sovranitetit të Kosovës. Sa i përket mundësisë për vitin e ardhshëm, është herët të flitet, meqë varet prej dinamikës së zhvillimeve brenda vendit dhe prej asaj se sa do të arrijmë t'i përmbushim pritjet.

**"Epoka e re":** Qeveria e Kosovës tashmë ka formuar ekipin negociator për dialogun

me Serbinë. Sa ka gjasa që ky ekip ta marrë mbështetjen e Kuvendit dhe pjesë e tij të bëhet edhe opozita?

**Hoxhaj:** Besojmë se do të ketë mirëkuptim dhe delegacionin që do të duhej të mandatohej nga Kuvendi ta përbëjë edhe opozita. Ka qenë kërkesë e opozitës që Kuvendi të vendosë se kush duhet të shkojë në Bruksel. Dhe, ne i kemi hedhur disa propozime si partnerë të koalicionit për nga fuqia e partive politike. Nëse edhe opozita do t'i dërgonte përfaqësuesit e vet, kjo do të ishte një kthesë në kulturën tonë politike, meqë nuk kemi betejë të brendshme, por betejën e kemi me Serbinë. Procesi ndërkombëtar i cili është para nesh do të jetë i vështirë dhe i komplikuar. Varet prej shumë rrethanave të njohura dhe të panjohura. Sikurse që presidenti Thaçi ka nevojë për mbështetje prej institucioneve qeverisës, por edhe prej opozitës që ta përmbyllim këtë proces. Mbetet të shihet se si do të jetë dinamika gjatë ditëve të ardhshme.

**"Epoka e re":** Duke i pasur parasysh ndasitë e krijuar në skenën politike jeni optimist se mund të arrihet konsensusi dhe të paktën një pjesë e opozitës ta përkrahë këtë proces?

**Hoxhaj:** Po punojmë që të ketë mirëkuptim dhe bashkëpunim politik drejt një konsensusi. Kemi pasur situata absurde edhe para një kohe kur skena politike ishte e përçarë për, gjoja, një marrëveshje jo të drejtë sa i takon demarkacionit me Malin e Zi. Ndërsa fakti se tash nuk merremi vesh as për formën e përfaqësimit tonë në dialog, as për përmbajtjen e dialogut, flet që është koha e fundit dhe janë kambanat e

fundit të alarmit që të gjithë në elitën politike do të duhej të ulemi dhe të merremi vesh se si të shtyhet dialogu përpara. Nëse dikush mendon se mund ta bllokojmë Serbinë duke i zvarritur punët tona të brendshme, duke moskrijuar një mirëkuptim dhe konsensus të brendshëm dhe që bashkësia ndërkombëtare ka kohë të pafundme që ta presë Kosovën, e kanë shumë gabim. Jam kundër asaj që ta ruajmë statusin kohën në Kosovë, por në përputhje me përgjegjësitë politike duhet ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës dhe ajo mund të ndodhë nëse vendi anëtarësohet në OKB. Historia e dhjetë vjetëve të fundit ka treguar se vendi nuk mund të anëtarësohet në OKB pa mbështetjen edhe të Rusisë e cila ndjek politikë të njëjtë me Serbinë.

**"Epoka e re":** Z. Hoxhaj, meqë jeni edhe zëvendëskryetar i PDK-së, mund të na tregoni se cili është qëndrimi i kësaj partie lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit me Serbinë?

**Hoxhaj:** Kjo temë besoj se është konsumuar. Z. Veseli ka folur për këtë temë në media, po ashtu kam folur edhe unë, si dhe kanë folur edhe zyrtarët e tjerë dhe qëndrimi i PDK-së është i qartë. Përtej asaj se si të krijojmë polarizim të brendshëm se kush çfarë tha, mendoj se presidenti Thaçi ka nevojë për mbështetjen e të gjitha subjekteve politike dhe PDK-ja e mbështet edhe në pozitën që ka institucionale, por edhe si ish-kryetar të saj. Fakti që nuk po arrijmë të kemi një delegacion dhe një platformë nuk ma merr mendja që vlen për një dimension të një ideje, prandaj është shumë me

rëndësi që të merremi me gjërat kyçe.

**"Epoka e re":** Pra, Thaçin e mbështesni edhe në idenë për korrigjim të kufirit?

**Hoxhaj:** Isha shumë i qartë. Jemi deklaruar deri më tani për këtë dhe është e konsumuar si temë. Çka po synoj të them është se jemi të interesuar të ulemi dhe të merremi vesh se si do të duket marrëveshja obligative dhe ligjore në mes të Kosovës dhe Serbisë.

**"Epoka e re":** Sidoqoftë, kjo ide në opinion po shihet si opsion i ndarjes apo shkëmbimit të territoreve, përkatësisht dhënie e veriut dhe marrjen e një pjese të Luginës së Preshevës. Po ashtu, ka pasur zëra se do të ketë edhe një lloj autonomie për veriun përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Cili është qëndrimi juaj lidhur me këto?

**Hoxhaj:** Qëndrimi ynë është ky: Do të bëjmë çdo gjë që Asociacioni për Komunitet me Shumicë Serbe të mos ketë kompetenca ekzekutive, të mos ketë karakter ekzekutiv dhe territorial. Dhe rreziku më i madh që mund ta ketë Kosova në procesin e dialogut është pikërisht themelimi i këtij asociacioni. E kam thënë disa herë deri më tash, se asociacioni, në bazë të rekomandimeve që i ka dhënë Gjykata Kushtetuese, do të duhej të themelohej në atë çast kur Kosova të anëtarësohet në OKB. Pa e marrë një qartësi të anëtarësimit tonë në OKB nuk ka nevojë të mendohet as koha e themelimit të këtij asociacioni. Jemi të interesuar që kjo të shihet në kuadër të arritjes së një marrëveshje obligative ligjore në mes të dy vendeve.

## Deri në fund të vitit PDK-ja do ta ketë konventën e re

**"Epoka e re":** Z. Hoxhaj, si është duke shkuar procesi zgjedhor brenda PDK-së dhe kur do ta kemi finalen e tij?

**Hoxhaj:** Po besoj se deri në fund të vitit do ta kemi konventën e re. Gjatë ditëve të ardhshme do të ketë fillim të

procesit zgjedhor në nivel të degëve. Deri më tani i kemi përmbyllur me sukses zgjedhjet në rininë demokratike dhe presim që tash të fillojë zgjedhja e forumeve të partisë në nivel të degëve. Jam shumë i sigurt se gjatë kësaj

kohe do të dalim edhe me një program të ri, me një platformë të re sikurse edhe me dokumente të reja strategjike si PDK. Jemi në përpjekje që ta hapim partinë, të sjellim sa më shumë mendje të reja dhe energji të reja në PDK.

konsiderojnë si skandaloze?

**Hoxhaj:** Qeveria në çdo vend të botës kritikohet dhe në këtë drejtim e kuptoj gjuhën dhe sjelljen e opozitës. Përgjegjësia politike në çdo demokraci nuk është vetëm e koalicionit qeverisës, por edhe e opozitës. Mbi të gjitha, partnerët e koalicionit dhe opozita duhet ta përfundojnë një temë të madhe siç është përmbyllja e shtetndërtimit dhe kompletimi i sovranitetit të Kosovës. Fakti që për tri ditë me radhë kemi hyrë të ndarë në seancat e Kuvendit të Kosovës me dy projektrezoluta dhe me dy forume jofunksionale parlamentare pa arritur asgjë, flet për atë se gjërat në Kosovë nuk janë në drejtimin e duhur dhe për këtë përgjegjësinë e mba-

# Serbët i mbesin besnik Beogradit, por marrin para edhe nga Prishtina

Prishtina dhe Beogradi paralelisht ndajnë miliona euro për katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovica e veriut. Por, këto mjete, sipas ekspertëve të ekonomisë dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare serbe, nuk dihet se ku dhe për çfarë shpenzohen

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Pjesa veriore e Kosovës që nga paslufta ka funksionuar mbi bazën e një sistemi paralel të organizuar nga Beogradi. Në kuadër të dialogut të Brukselit, Prishtina dhe Beogradi kanë arritur marrëveshje për integrimin e kësaj pjese në kuadër të sistemit ligjor-kushtetues të Kosovës, ku investimet përbënin një element të rëndësishëm krahas zgjedhjeve të lira, por që e ky proces integruës mbetet i papërfunduar. Eksperti i çështjeve ekonomike, Naim Gashi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në 20 vjetët e fundit nuk ka asnjë informacion se si janë shpenzuar qindra miliona euro taksa të qytetarëve të Kosovës, donacionet nga ndërkombëtarët, por edhe fondet që Qeveria e Serbisë jep

për ta penguar integrimin e komunitetit serb në institucionet e Kosovës. "Nëse marrim parasysh të gjitha investimet që deklarohen nga Qeveria e Serbisë dhe ato që shkojnë nga Qeveria e Kosovës për veriun e vendit, sikur ato të ishin shkuar në projekte zhvillimore, atëherë veriu i vendit do të lulëzonte. Në fakt, duke mos pasur integrim të komunitetit serb në institucionet e Kosovës dhe shkaku i pamundësisë që të shtrijë autoritetin atje si auditorët dhe institucionet e drejtësisë, ka mundësiar që atje të bëhet keqpërdorim i madh i mjeteve buxhetore të Kosovës dhe nuk duhet përrjashtuar mundësinë se atje lulëzon edhe keqpërdorimi i mjeteve që vijnë nga Qeveria e Serbisë", ka deklaruar Gashi.

Ai ka shtuar se pjesa dërrmuese e këtyre mjeteve që investohen nga buxheti i Kosovës dhe ai i Serbisë shkojnë në grupe të cilat nuk përfillin asnjë ligj të Kosovës. Kjo mosllogaridhënie për mjetet e Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, që ndahen për veriun, sipas Gashit, duhet të ndërpritet. "Shtrirja e rendit dhe ligjit në çdo pjesë të Kosovës është imediate dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore pa ndonjë kontroll dhe pa raporte të detajuara financiare nuk duhet të ndodhë për arsye se çdo euro taksë e shpenzuar e qytetarëve duhet të ketë llogaridhënie për çka janë investuar, cilat procedura të prokurimit janë ndjekur dhe cili ka qenë rezultati i tyre", është shprehur Gashi.

Ndërsa Nenad Maksimoviq nga Qendra për Paqe dhe Tolerancë në Graçanicë ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se është vështirë për të bërë një vlerësim objektiv të ndikimit të të gjitha financimeve që janë bërë në veri. "Nuk kemi ndonjë raport të Komisionit për Anketim të Republikës së Serbisë për financimin e të gjitha

aktiviteteteve nga ana e Serbisë në gjithë territorin e Kosovës. Në anën tjetër, Fondi për Veriun, me të cilin mblidhen taksat doganore nga vendkalimet kufitare në veri të Kosovës, punojnë me kapacitete të kufizuara dhe deri më tash janë zbatuar vetëm disa projekte infrastrukturore. Mbase mund të shohim përparim të dukshëm të projekteve infrastrukturore, por që deri më tash nuk kanë ndikuar në mënyrë të rëndësishme në jetën e popullatës. Do të thotë, edhe më tutje, të gjitha financimet nga institucionet qendrore po mbahen në njëfarë mënyre sekrete dhe qytetarët nuk e dinë në masë të madhe se në çfarë mënyre janë shpenzuar ato fonde", ka thënë Maksimoviq. Ai ka shprehur mendimin që, megjithatë, ata që është dashur të jenë shfrytëzues të këtyre fondeve nuk kanë parë rezultate konkrete.

Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ditë më parë ka njoftuar se është përgatitur plani i investimeve të projekteve në 10 komunat me shumicë serbe në Kosovë. Investimet e Serbisë në

këto komuna të banuara me shumicë serbe arrijnë shumën e rreth 200 milionë euro. "Investimet më të mëdha do të bëhen për të punësuarit në arsim e në shëndetësi (71 milionë euro), për vendbanimin 'Lugina e Diellit' (25 milionë euro), për 'Trepçën' (13 milionë euro), për Qendrën Spitalore (10 milionë euro), për ujësjellësin (6 milionë euro)", thuhet në një njoftim të zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.

Për më shumë investime në komunat në veri të Kosovës, në vitin 2013, në bazë të marrëveshjes së përkohshme për doganat, të arritur në dialogun Kosovë - Serbi, ishte krijuar edhe Fondi i Mirëbesimit. Në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë" nga Zyra për Informim e Ministrisë së Financave, totali i mjeteve të transferuara nga viti 2013 deri tani nga llogaria e buxhetit të Kosovës në llogarinë për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit është mbi 15 milionë euro, prej të cilave në vitin 2018 (1 janar - 7 shtator) janë transferuar mbi 1.2 milion euro.



Armand Nimani (AFP)

## Shqiptari Adnan Dibrani fiton ulësen e deputetit në Parlamentin e Suedisë

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Adnan Dibrani ka fituar mandatin e tretë të deputetit në Parlamentin e Suedisë. Duke qenë shqiptari i vetëm që ka fituar ulëse në parlamentin suedez, ai ka theksuar se meritë për këtë janë bashkatdhetarët të cilët jetojnë në Suedi.

"Partinë dhe shqiptarët i kam pasur krah, prandaj ka ardhur sukcesi", ka thënë Dibrani për "Klan Kosova". "Është shumë ndjenjë e mirë, veçanërisht pasi kjo është hera e tretë që zgjedhem deputet. Ka pasur edhe shqiptarë të tjerë në garën zgjedhore por

tash, pas zyrtarizimit të rezultateve, kanë mbetur nëpër nivele të tjera, nëpër komuna", ka thënë ai. Dibrani ka thënë se ka pasur rreth gjashtë për qind të votave të partisë, kurse ka përmendur se të gjithë ata që kanë vota mbi pesë për qind nga totali sa ka partia, e

kanë të sigurt ulësen në parlament. Është Partia Socialdemokrate, së cilës i përket ai, që ka dalë fituese në zgjedhje me mbi 28 për qind.

Dibrani ka migruar në Suedi me familje në vitin 1992 dhe është nga Mitrovica.



# Lobi i Grave të Rajonit të Evropës Juglindore Juglindore kundër ndryshimit të kufijve

Lobi i Grave të Rajonit të Evropës Juglindore (LRGEJL) dhe gratë deputete nga Kosova dhe Serbia janë shprehur kundër idesë së ndryshimit të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. LRGEJL-ja përmes një deklarate ka shprehur shqetësimin me zhvillimet e fundit rajonale të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikojnë proceset e paqes dhe të sigurisë jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

Durrës, 16 qershor - Lobi i Grave të Rajonit të Evropës Juglindore (LRGEJL) dhe gratë deputete nga Kosova dhe Serbia kanë dalë me një deklaratë kundër ndryshimit të kufijve në rajon. Kjo deklaratë është miratuar në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Durrës më 15 shtator, ku kryetare e LRGEJL-së është ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri.

Lobi i Grave të Rajonit të Evropës Juglindore (LRGEJL) ka shprehur shqetësimin me zhvillimet e fundit rajonale, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikojnë proceset e paqes dhe sigurisë jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë. "Të shqetësuara me tendencat destabilizuese në rajonin e Ballkanit, të cilat nxorën në sipërfaqe idetë e rrezikshme të ndryshimit të mundshëm të kufijve, pas shumë vitesh të promovimit të një sërë vlerash të integritimit në BE të të gjitha gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor", thuhet në deklaratën e LRGEJL-së.

Më tej, në këtë deklaratë thuhet se LRGEJL-ja është shqetësuar edhe për mungesën e mbështetjes së BE-së, ShBA-së për të drejtat e njeriut dhe të pakicave si një kornizë për garantimin e shoqërive dhe shteteve shumetnike dhe përqendrimin e tyre në

stabilitet dhe siguri si prioritet. "Duke pasur parasysh se integrimi evropian i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe parimet e gërshtuara në procesin e demokratizimit sikurse janë: sundimi i ligjit, koncepti shumetnik, të drejtat e njeriut, toleranca, pluralizmi dhe pajtimi, çojnë drejt anëtarësimit në BE. Të udhëhequra nga këto parime, LRGEJL dhe pjesëmarrëset e tjera të takimit të Durrësit morën qëndrim të fuqishëm kundër ndryshimit të kufijve në rajon, sepse kjo do të çonte në jostabilitet dhe pasojë të paparashikueshme për rajonin dhe më gjerë. Ndikimi negativ i saj çon në një radikalizim më të gjerë që do ta pengonte procesin e demokratizimit dhe perspektivën evropiane për të cilën kemi investuar për më shumë se 20 vjet", është theksuar në këtë deklaratë të LRGEJL-së.

Më tej thuhet se duke pasur parasysh se rajoni aktualisht është i ekspozuar ndaj interesave konfliktuale gjeostrategjike, LRGEJL-ja konsideron se përshpejtimi i integritimit në BE i vendeve të Ballkanit do ta parandalonte hapjen e agjendave të tjera që do t'i dëmtonin proceset dhe arritjet që janë në vazhdim e sipër. "Ne mbështesim fuqimisht vazhdimin e dialogut të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe



Beogradit, të ndërmjetësuar nga BE-ja, që çon në një marrëveshje përfundimtare në funksion të një paqeje dhe stabiliteti të qëndrueshëm në rajon. Ne kërkojmë fuqishëm që të përfshihen gratë në procesin e dialogut në pajtim me rezolutën e 1325 të KS të OKB-së dhe politikën për barazi gjinore të BE-së", është theksuar në deklaratën e Lobit të Grave të Rajonit të Evropës Juglindore (LRGEJL).

Pjesëmarrëse në këtë takim ishin Edita Tahiri, kryesuese; Gordana Sobol, anëtare e Komitetit Drejtues të LRGEJL; Sonja Biserko, anëtare e Komitetit Drejtues të LRGEJL, drejtoreshë e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat Njerëzore në Serbi; Eglantina Gjermeni, anëtare e Komitetit Drejtues të LRGEJL dhe anëtare e Parlamentit,

ish-ministre e Zhvillimit Urban në Shqipëri; Irina Pockova, anëtare e Komitetit Drejtues të LRGEJL dhe anëtare e Kartës së Grave në partinë politike SDA të Sveti Nikola në Maqedoni; Memnuna Zvizdiq, anëtare e Komitetit Drejtues të LRGEJL dhe drejtoreshë ekzekutive "Zene Zenama", Bosnje dhe Hercegovinë; anëtarët e Parlamentit nga Beogradi: Gordana Comic (DP); Natasha Mićiq, LDP, anëtare e LRGEJL në Serbi; anëtare e Parlamentit Kosovë: Xhevahire Izmaili (PDK), Mexhide Mjaku-Topalli (PDK); Hykmete Bajrami (LDK); Time Kadrijaj (AAK), Vlora Nushi, zyrtare përgjegjëse për zyrën UN Women në Kosovë, Diana Çekaj-Berisha, koordinatore, kurse Arbresha Dedinja u është drejtuar të pranishmëve përmes prezan-

imit me "Skype".

LRGEJL është një organizatë rajonale unike për ndërtimin e paqes në rajon, e themeluar në vitin 2006. Misioni i saj është fuqizimi i grave në proceset e paqes dhe vendimmarrja në përpjekjet për ta promovuar paqen, stabilitetin dhe integritimin evropian dhe euroatlantik të të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ajo konsideron se më shumë gra të përfaqësuara në procesin e paqes dhe proceseve politike sjell rezultate më të mira dhe më të qëndrueshme. Anëtarët e saj janë gra të nivelit të lartë nga politika, parlamentet, qeveritë dhe shoqëria civile nga shtatë vendet anëtare: Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia.

## Ministri Matoshi dhe kryetari Bahtiri pastrojnë Mitrovicën

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, të dielën së bashku me kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, kanë marrë pjesë në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", i cili aksion ka filluar më 15 shtator.

Matoshi para qytetarëve të mobilizuar për këtë aksion ka thënë se Komuna e Mitrovicës dhe e gjithë Kosova do të jenë më të pastra falë vullnetit të të gjithëve. "E filluam në Mitrovicë dhe do të zgjasë deri më 22 shtator në të gjitha qytetet e Republikës së Kosovës. Jemi këtu për t'i dhënë mbështetje edhe aksionit 'Ta pastrojmë Kosovën' që e kemi filluar dje dhe do të

vazhdojë deri më 15 dhjetor", ka thënë Matoshi. Ai ka falënderuar qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve, bashkësitë fetare, FSK-në dhe KFOR-in për mbështetje në këtë aksion për pastrimin e vendit.

Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pohuar se kjo komunë do t'u ngjajë komunave evropiane. Ministri Matoshi së bashku me kryetarin Bahtiri kanë filluar aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", duke përshkruar rrugën nga objekti i Komunës së Mitrovicës deri te rrethi në pjesën veriore. Së bashku, Matoshi dhe kryetari Bahtiri u janë bashkangjitur vullnetarëve për të pastruar edhe në fshatin Bare të Mitrovicës.



Flet për "Epokën e re", Sala Berisha-Shala

# Duhet të rritet llogaridhënia në të gjithë

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, ka thënë se është çasti i fundit kur kryesuesit e Ndërmarrjeve Publike (NP) në vend duhet të reflektojnë karshi obligimeve ligjore. Në një intervistë për gazetën "Epokën e re" ajo ka thënë se këto ndërmarrje duhet të jenë në trend me zhvillimet e tregut dhe konkurrencën e lirë. Ndërsa duke iu referuar zhvillimeve të fundit në Postën e Kosovës, ajo ka thënë se do të duhej të ndodhte nivelimi i pagave në këtë ndërmarrje. Kurse sa i përket zvarritjes së draftstatutit të "Trepçës", Berisha-Shala ka thënë se ka interferime politike në këtë drejtim

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, ka thënë se është çasti i fundit kur kryesuesit e Ndërmarrjeve Publike (NP) në vend duhet të reflektojnë dhe t'i menaxhojnë situatat e krijuara konform ligjeve në fuqi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se Ndërmarrjet Publike (NP) duhet të jenë në trend me zhvillimet e tregut dhe konkurrencës së lirë. "Nivelet menaxheriale të ndërmarrjeve duhet të jenë në nivelin e duhur menaxhues, sidomos në fazën e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë. Duhet të jenë në trend me zhvillimet e tregut të lirë dhe konkurrencës dhe se politikatat financiare duhet t'i kenë në përputhshmëri, harmoni të plotë me aftësitë hyrëse financiare të ndërmarrjes. Po ashtu, duhet rritur llogaridhënia në të gjitha NP-të, në raport me aksionarin e në këtë kuptim dhe harmonizimi i pagave dhe shpenzimeve të tjera investive. NP-të dhe nivelet menaxhuese duhet të mendojnë dhe punojnë që të jenë likuide dhe të jenë kontribuuese të buxhetit të shtetit. Pra, konsideroj se është momenti i fundit që të gjitha ndërmarrjet dhe agjencitë e tjera ta arsyetojnë qëndrueshmërinë e tyre", ka thënë Berisha Shala, duke shtuar se në Postën e Kosovës duhet të ketë nivelim të

pagave në mënyrë që të dilet nga kriza financiare. "Sigurisht se do të duhej të kishte nivelizim të pagave. Kjo do të shmangte edhe mbi punësimin në ndërmarrje publike. Nga ana tjetër, politikatat menaxhuese me NP-të janë të rregulluara me ligjet në fuqi", është shprehur Berisha-Shala. Në këtë intervistë, Berisha-Shala, e cila është deputete nga radhët e PDK-së, ka folur edhe për situatën politike në vend, problemet në ndërmarrjen "Trepça" dhe për Postën e Kosovës. Sa i përket problemeve të gërshetuara në mes të politikës dhe sindikatës në "Trepçë", ajo ka thënë se në këtë ndërmarrje ka interferenca politike të bllokimit me qëllim të bllokimit të saj. Në këtë kontekst, ajo ka akuzuar dhe polin opozitar që, sipas saj, "po veprojnë për çështje të çastit dhe poenë politike". Po ashtu, ajo ka thënë se për gjendjen në "Trepçë" një pjesë të përgjegjësisë e ka edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE).

"Një pjesë të përgjegjësisë është edhe te Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe mekanizmat e tjerë menaxhues që ndër lidhen me hartimin e draftstatutit me hartimin e draftstatutit me harmonizimin e kërkesave sindikale", ka deklaruar Berisha-Shala.

**"Epoka e re":** Znj. Berisha-Shala, si e vlerësoni rrjedhën e zhvillimeve ekonomike?

**Berisha-Shala:** Rrjedha e zhvillimeve ekonomike është e pandashme nga rrjedha historike, përfshirë edhe ato politike të vendit. Nisur nga fakti se Kosova është shtet i ri dhe është krijuar pas një lufte shkatërrimtare mund të themi se rrjedhat ekonomike janë në rrugë të drejtë dhe prosperuese, ndoshta më të avancuara se rrjedhat politike të shtetit të Kosovës. Pra, bindja ime është që ka hapësirë të madhe që rrjedhat zhvillimore të dinamizohen fuqishëm. Do të dinamizohen nëse vazhdojmë ta

përmirësojmë jo vetëm mjedisin legjislativ për mënyrën e të bërit biznes, mënyrën e thithjes së investimeve të jashtme, por t'i përmirësojmë dhe fuqizojmë energjitë tona për riaktivizimin e kapaciteteve në industrinë përpunuese minerare e cila do të na hapte mundësi eksporti dhe tërheqjeje të investitorëve strategjikë. Funkcionalizimi i sektorëve strategjikë për zhvillimin ekonomik të vendit do ta ndryshonte pozitivisht rrjedhën e zhvillimeve ekonomike. Një nga këta sektor është sektori mineral i përfaqësuar me mineral të linjtit dhe plumb-zink. Që të dyja këto minerale janë si pjesë e ndërmarrjeve publike, që vazhdojnë të subvencionohen nga shteti dhe që kanë performancë jo të mirë.

**"Epoka e re":** Kanë kaluar gati dy vjet nga miratimi i Ligjit për "Trepçë"-n, ndër kohë që ende diskutohet për draftstatutin e kësaj ndërmarrje. Pse e gjithë kjo

neglizhencë?

**Berisha-Shala:** Ka qenë lajm i mirë para dy vjetëve hyrja në fuqi e Ligjit për "Trepçë"-n. Por, për fat të keq, ende nuk shohim hapa konkretë të zbatimit të tij, e që do ta funksionalizonte ndërmarrjen. Përkundër miratimit të ligjit dhe vullnetit që patën deputetët e asaj legjislature, ka dozë të një vetëkënaqësie në të gjitha nivelet institucionale dhe menaxhuese në "Trepçë". Pjesë tjetër e këtij problemi është edhe situata e brishtë politike që nënkupton edhe moskompletimi i bordit të "Trepçës" dhe vazhdimi i qasjes negative penguese i pjesës kundërshtarë të funksionalizimit të "Trepçës". Një pjesë të përgjegjësisë është edhe tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe mekanizmat e tjerë menaxhues që ndër lidhen me hartimin e draftstatutit dhe me harmonizimin e kërkesave sindikale.

**"Epoka e re":** A kemi të bëjmë me



# ha ndërmarrjet publike



janë nënshkruarit e marrëveshjes së fundit, MZHE-ja dhe sindikata. Komisioni parlamentar të cilin e kryesoj unë do ta procedojmë sa më parë që është e mundur statutin final për "Trepçën", sa më parë që është e mundur, sapo Qeveria ta sjellë në Kuvend.

**"Epoka e re":** Znj. Berisha-Shala, këto ditë kemi pasur protestë të punëtorëve të Postës së Kosovës për shkak të mosmarrjes së pagave, kurse paga mesatare llogaritet të jetë 700 euro. Sipas jush, a duhet të bëhet nivelim i pagës në përputhje të pagës mesatare në Kosovë?

**Berisha-Shala:** Sigurisht se do të duhej të kishte nivelizim të pagave, sepse do të shmangej edhe mbipunësimi në ndërmarrje publike. Nga ana tjetër, politikat menaxhuese me NP-të janë të rregulluara me ligjet në fuqi. Nivelet menaxheriale të ndërmarrjeve duhet të jenë në nivelin e duhur menaxhues, sidomos në fazën e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë. Duhet të jenë në trend me zhvillimet e tregut të lirë dhe konkurrencës dhe se politikat financiare duhet t'i kenë në përputhshmëri, harmoni të plotë me aftin hyrës financiar të ndërmarrjes. Po ashtu, duhet rritur llogaridhënia në të gjitha NP-të, në raport me aksionarin e në këtë kuptim, edhe harmonizimi i pagave dhe shpenzimeve të tjera investive. NP-të dhe nivelet menaxhuese duhet të mendojnë dhe punojnë që të jenë likuide dhe të jenë kontribuuese në buxhetin e shtetit. Pra, konsideroj se është momenti i fundit që të gjitha ndërmarrjet dhe agjencitë e tjera ta arsyetojnë qëndrueshmërinë e tyre.

çështje politike brenda vendit apo kemi me ndonjë ndërhyrje të shtetit fqinj, Serbisë?

**Berisha-Shala:** Cilado që të jetë, minuset shkojnë tek institucionet tona. Resurset minerale janë kategori kushtetuese të rregulluara dhe me ligj të veçantë. Konsideroj se është kompetencë kushtetuese dhe ligjore e institucioneve të Republikës së Kosovës nisur nga fakti se resurset minerale janë kategori kushtetuese dhe duhet të veprojnë shteti dhe ligji. Qeveria është e obliguar t'i zbatojë ligjet që i nxjerr Kuvendi. Në këtë pikë është dashtë të këmbëngulë edhe opozita, e jo të bëhet pjesë e prolongimit të statutit të "Trepçës" për përfitime politike të rastit.

**"Epoka e re":** Në këtë kontekst është vendosur të formohet një grup punues sa i përket draft-statutit dhe pakënaqësive të sindikatës, ndërkohë që nuk është mbajtur asnjë takim i këtij

grupi. Kur pritet të kemi rezultate konkrete?

**Berisha-Shala:** Saktësisht në këtë situatë tani kemi përfshirje të politikës në procesin e miratimit të statutit. Kërkesat e caktuara që bien ndesh me ligjin dhe me konceptin zhvillimor të "Trepçës" janë të panevojshme dhe zvarrisin procesin e konsolidimit juridik dhe ekonomik të "Trepçës". Lojërat dhe marrëveshjet e shkruara dhe të pashkruara me grupet e interesit, me grupe sindikale e institucione shtetërore, pa ndonjë qartësi dhe objektiv të qartë, nuk mund t'i kuptoj ndryshe vetëm se tendencë politike dhe opozitare për tek krijuar probleme sociale dhe imazh të keq për menaxhmentin, sindikatën si dhe ministritë gjegjëse. Bazuar në marrëveshjen e fundit që ka MZHE-ja me sindikatën, rezultoni që do të duhej të vinte në Kuvend shumë shpejt drafti final i statutit të "Trepçës". Krejt në fund përgjegjës dhe obligues

**"Epoka e re":** Mosrishikimi i buxhetit, sa ka shkaktuar vakum sa iu përket kërkesave buxhetore?

**Berisha-Shala:** Rishikimi i buxhetit zakonisht bëhet në muajin korrik dhe ka për qëllim përshtatjen e buxhetit varësisht se si ka rrjedhur dinamika e grumbullimit të të hyrave dhe shpenzimit të mjeteve buxhetore. Kuvendi, përkatësisht deputetët, është mirë ta dinë se si ka ardhur deri në këtë fazë, sa janë realizuar projektet, sa janë bërë shpenzime, sa janë shpenzuar brenda të hyrave buxhetore etj. Dhe tërë kjo është në të mirën e transparencës. Përndryshe, rishikimi i buxhetit nuk është obligim ligjor dhe Qeveria nuk e sjell fare në Kuvend nëse mendon se nuk do të ketë reflektim negativ ose nuk do të shkaktonte eventualisht ndonjë vakum sa iu përket kërkesave buxhetore.

## Kosova i shkruan letër Shqipërisë për taksën për 'Rrugën e Kombit'

Sipas vendimit të Qeverisë së Shqipërisë, i cili pritet të hyjë në fuqi sot (17 shtator), të gjithë ata që udhëtojnë në "Rrugën e Kombit" në pjesën e Shqipërisë, e cila është e gjatë 114 kilometra, për kalim në dy drejtime do t'i paguajnë tarifat për veturë pesë euro, autobusë dhe kamionë me peshë më të vogël, 11.20 euro, për kamionët e mesëm 16.20 euro dhe për kamionët e rëndë 22.50 euro

**PRISHTINË, 16 SHTATOR** - Vendosja e taksës për qarkullim në autostradën "Rruga e Kombit" nga autoritetet e Shqipërisë ka ngjallur reagime të shumta te komuniteti i biznesit dhe qytetarët që kalojnë kufirin. Sipas vendimit të Qeverisë së Shqipërisë, i cili pritet të hyjë në fuqi sot (17 shtator), të gjithë ata që udhëtojnë në "Rrugën e Kombit" në pjesën e Shqipërisë, e cila është e gjatë 114 kilometra, për kalim në dy drejtime do t'i paguajnë tarifat për veturë pesë euro, autobusë dhe kamionë me peshë më të vogël, 11.20 euro, për kamionët e mesëm 16.20 euro dhe për kamionët e rëndë 22.50 euro. Autostrada që lidh Shqipërinë me Kosovën ishte lëshuar në qarkullim në vitin 2009. Ndërkaq, Kosova përfundoi ndërtimin e autostradës "Ibrahim Rugova" në vitin 2013. Zëvendësministër i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se që nga muaji maj i kanë dërguar shkresë zyrtare, ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë në

Qeverinë e Shqipërisë, Demian Gjoknuri, por deri më tani nuk kanë marrë ndonjë përgjigje. "Mirëpo, kjo taksë atakon drejtpërdrejt qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse frekuentimi më i madh i 'Autostradës së Kombit' është pikërisht nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Nëse thirrmi ne se është 'Autostradë e Kombit', atëherë për cilin komb po flitet, dhe realisht nuk janë marrë për bazë kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve tanë", ka thënë Kadriu.

Qeveria e Shqipërisë një vendim për zbatimin e taksës rrugore e kishte marrë në muajin prill, por që kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e kishte pezulluar taksën për shkak se kjo taksë ishte kundërshtuar me anë të protestave nga qytetarët e veriut të Shqipërisë dhe të Kosovës, të cilët thanë se tarifa është shumë e lartë. Sipas shifrave zyrtare, vetëm në vitin 2017 në kufirin me Shqipëri janë regjistruar mbi dy milionë hyrje dhe dalje të automjeteve, kamionëve dhe autobusëve.



## Në Ferizaj policia bastisi dy shtëpi, gjen një pistoletë me pesë fishekë

FERIZAJ, 16 SHTATOR (ER) - Në Komunën e Ferizajt nga njësitet e Drejtorisë për Hetimin e Krimin të Organizuar janë bastisur shtëpitë e dy të dyshuarve, ku është gjetur dhe

konfiskuar një armë pistoletë me pesë fishekë. Sipas Policisë së Kosovës, nuk raportohet për të arrestuar, por me urdhër të prokurorit rasti shkon në procedurë të rregullt.



## Në Mazhiq u përkujtuan dëshmorët Avni Shabani dhe Rifat Zeneli

MITROVICË, 16 SHTATOR (ER) - Në Mazhiq të Shalës së Bajgorës është mbajtur akademi përkujtimore në 20-vjetorin e rënies së dëshmorëve të Kosovës, Avni Shabani dhe Rifat Zeneli. Përveç qindra qytetarëve të këtij fshati, të rajonit të Shalës së Bajgore, Mitrovicës e më gjerë, në akademi ishin të pranishëm edhe kryetari i komunës, Agim Bahtiri,

nën përkujdesjen e të cilit edhe është mbajtur akademi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, familjarë të heroit e dëshmorit, bashkëluftëtarë të tyre dhe shumë personalitete të tjera.

I pari që foli në akademi ishte kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, i cili edhe me këtë rast ka thënë se Shala e Bajgorës ka

dhënë shumë luftëtarë trima, heronj e dëshmorë dhe se ai është krenar me njerëzit e këtij rajoni. "Luftëtarët e lirisë, Avni Shabani dhe plaku Rifat Zeneli, u dalluan për guxim dhe trimërinë e treguar në luftë kundër pushtuesit. Ata janë dy emblema të Komunës së Mitrovicës që do të kujtohen me krenari përgjithmonë", ka thënë Bahtiri.

## Grabitet një filiale e bankës në Obiliq

OBILIQ, 16 SHTATOR (ER) - Në rrugën "Hasan Prishtina" në Obiliq tre persona të maskuar dhe të armatosur kanë grabitur dje një filiale të bankës. Sipas policisë, të

tre personat pas grabitjes së filialit bankar janë larguar me një veturë në drejtim të panjohur. Njësia përkatëse policore është duke hetuar rastin.



## Dëmtohen varrezat në fshatin Llapashticë të Poshtme të Besianës

BESIANË, 16 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se në fshatin Llapashticë të Poshtme në Besianë, dy qytetarë kanë raportuar se janë dëmtuar 81 gurë dhe piramida të varrezave. Njësia policore pas hetimeve ka arritur të iden-

tifikojë një të dyshuar për këtë akt, i cili thuhet se ishte me probleme psikike. "Pas konsultimit me prokurorin i dyshuari është liruar pasi i njëjti është i papërgjegjshëm për veprimet e tij", është thënë në njoftimin e policisë.



## Haradinaj: Banorët e Podgorit do ta kenë mbështetjen e Qeverisë

PODGOR, 16 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar fshatin Grnçar të rajonit të Podgorit. Në shenjë respekti për këtë vizitë, Shoqata Kulturore Artistike "Podgorski Biseri" ka organizuar një program artistik kulturor me vallet tradicionale të kësaj zone.

Me këtë rast para të pranishmëve të shumtë kryeministri Haradinaj nga banorët u njoftua për shqetësimin e tyre rreth mungesës së ujit të pijshëm,

duke e konfirmuar atë se Qeveria do ta mbështesë kërkesën e tyre për investim në ujësjellës për t'ua sjellë atyre ujin e pijshëm.

Kryeministri Haradinaj i falënderoi banorët për mikpritje dhe i përgëzoi për ruajtjen e vlerave kulturore tradicionale. "Ju përgëzoj për ruajtjen e vlerave tuaja tradicionale si dhe, pavarësisht prej sfidave që jeni përballur si komunitet, keni vazhduar të qëndroni në vendet e tuaja të lindjes.

Qeveria ime do t'i ketë parasysh kërkesat tuaja, sidomos mungesën e ujit të pijshëm me të cilën ju ballafaqoheni, por do ta keni përkrahjen time përmes investimit për zgjidhje të këtij problemi", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq edhe ministri Rasim Demiri ka thënë se ndihet krenar që është pjesë e qeverisjes Haradinaj, duke vlerësuar se komuniteti boshnjak në asnjë Qeveri më herët nuk ka qenë më shumë i përfaqësuar në institucionet qendrore.

# Korrigjimi paqësor i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



Shkruan: Hashim  
THAÇI

Unë jam i sigurt se në politikën kosovare, tek qytetarët e Kosovës, nuk ka aspak dyshim se ne, si udhëheqës institucionalë të Kosovës, duhet të punojmë bashkë me qëllim që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore, t'i japim fund bisedimeve me Serbinë, duke nënshkruar marrëveshjen për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Ne kemi luftuar kundër okupimit të dhunshëm nga Serbia dhe kemi fituar lirinë në qershorin e vitit 1999. Kjo histori është e njohur për të gjithë ne, sepse ka bashkuar të gjithë shqiptarët dhe Kosovën me Perëndimin, në radhë të parë me SHBA-në, Aleancën Veriatlantike dhe BE-në.

Ne, së bashku me aleatët tanë, arritëm ta bëjmë Kosovën shtet në shkurtin e vitit 2008 dhe prej atëherë jemi njohur nga 116 shtete anekënd botës. Megjithatë, të gjithë ne e dimë fare mirë se stabiliteti afatgjatë i shtetit të Kosovës është pashmangshëm i lidhur me anëtarësimin e Kosovës si shtet në OKB, në Paktin NATO dhe në BE.

Në këtë mënyrë, Kosova do të jetë përjetë e mot shtet i qëndrueshëm, anëtare e familjes së kombeve paqedashëse në OKB, anëtare e aleancës më të fuqishme ushtarake në botë, NATO-s, si dhe në fund edhe anëtare e Bashkimit Evropian. Nuk mund t'i arrijmë këto qël-

lime, nuk mund ta vulosëm njëherë e përgjithmonë fatin e Kosovës si shtet, nëse në muajt e ardhshëm nuk do ta bëjmë marrëveshjen ligjrisht obliguese me Serbinë.

Shumë prej jush mund të thonë që si shtet kemi merituar që rrugëtimi ynë drejt OKB-së, NATO-s dhe BE-së të jetë më ndryshe, më i lehtë, më i shpejtë dhe të mos varej më nga marrëveshja paqësore me Serbinë. Keni të drejtë në këtë qëndrim tuajin, por ja që realiteti rajonal dhe ndërkombëtar imponon arritjen e marrëveshjes për normalizim për të dy shtetet, si kusht i domosdoshëm për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Marrëveshja mund të arrihet vetëm nëse palët bëjnë kompromis. Ju mund të thoni përsëri se Kosova tashmë i ka bërë të gjitha kompromiset e dhimbshme. Unë përsëri pajtohem me ju. Por, realiteti është edhe më kokëfortë se argumentet tona. Njohja nga Serbia është bërë pengesa primare për rrugëtimin tonë euroatlantik. Dikush mund të thotë se Serbia duhet ta njohë Kosovën pa kushte dhe brenda këtyre kufijve. Edhe unë dua të njëjtën gjë. Por, a mendoni se ne do ta bindim Serbinë ta bëjë një gjë të tillë së shpejti? Fatkeqësisht, jo. Po BE-ja dhe aleatët tanë të fuqishëm: SHBA-ja, Gjermania, Anglia, Franca, Italia e shumë të tjerë, a mendoni se do ta bindin Serbinë ta njohë Kosovën? Përsëri, jo. Nuk kanë mundur ta bindin të bëjë një gjë të tillë deri më sot dhe nuk mund të garantojnë se do ta bëjnë nesër apo në të ardhmen e afërt. Si rezultat, përgjegjësia mbetet tek ne.

Për ta arritur këtë qëllim, unë kam propozuar opsionin e korrigjimit të kufirit me

Serbinë. Kam argumentuar se marrëveshja eventuale e korrigjimit paqësor të kufirit me Serbinë, Kosovës i siguron njohjen nga Serbia dhe bashkëngjitjen e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me vendin tonë. Kam pritur kundërargumente racionale, por deri më sot kam dëgjuar më tepër zhurmë dhe në rastin më të keq edhe urrejtje. Kosova është vend shumë i vogël për të prodhuar kaq urrejtje, e cila e ndan shoqërinë tonë.

Tashmë të gjithë e dimë që Kosova është trajtuar përherë si rast i veçantë apo 'Sui Generis', në ndërmarrjen e madhe ndërkombëtare të zgjidhjes së çdo procesi rreth saj. Në këtë kontekst, lufta për liri, intervenimi humanitar i NATO-s, shpallja e pavarësisë së Kosovës në mënyrë të koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare, pavarësia e mbikëqyruar dhe shtetndërtimi, janë vetëm disa nga veçoritë që e kanë bërë Kosovën të trajtohet si një rast i veçantë. Dilemat vendore dhe ndërkombëtare i kanë shoqëruar të gjitha këto procese. Kështu, në prag të shpalljes së deklaratës së pavarësisë, kishte shqetësime se Kosova mund të shërbente si rast precedent për vende apo rajone të tjera në botë. Por, këto shqetësime dolën të pasakta. Gjithashtu, një shqetësim tjetër i madh ishte frika nga eksodi masiv i komunitetit serb që jeton në Kosovë, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë. Edhe ky paragjykim doli i gabuar.

Kosova tani është shtet i pavarur dhe ne jemi në fazën përfundimtare të shtetndërtimit. Por, edhe tani ka dilema, njësoj sikurse më herët. Çuditërisht, në kohën kur

Kosova e ka të hapur mundësinë për të arritur marrëveshje paqësore me Serbinë, rrufeshëm dhe nga shumë drejtime, ngritën shqetësime të paqëndrueshme. Sceptikët, sot përsëri janë bërë bashkë për të kundërshtuar opsionin real të korrigjimit paqësor të kufirit me Serbinë, si mundësi e njohjes reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë. Po e përsëris: korrigjimi i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete të pavarura, të cilat do ta njohin njëra-tjetrën si shtete, do të jetë pjesë përbërëse e demarkacionit të kufirit të gjatë 430 kilometra. Dyshuesit në marrëveshjen ligjrisht obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë, me lehtësi po përhapin frikë për gjoja destabilizim të rajonit dhe thellim të ndarjes etnike në Ballkan. Po krijojnë panik dhe mjegull, duke i trilluar të njëjtat argumente, njësoj sikurse në prag të shpalljes së pavarësisë.

Kam konsideratë të lartë për të gjithë ata që në mënyrë racionale janë të përfshirë në këtë debat, por atyre që prodhojnë vetëm zhurmë dhe panik, me keqardhje u them se janë të gabuar.

Në ditët e kaluara kam pasur takime shumë të rëndësishme me politikanët kryesorë të shteteve fqinje të rajonit. Së pari takova Ilir Metën, presidentin e Shqipërisë, pastaj në Podgoricë u prita nga Millo Gjukanoviq, presidenti i Malit të Zi, si dhe në fund bisedova në Shkup edhe me Zoran Zaevin, kryeministrin e Maqedonisë.

Në të gjitha këto bisedime miqësore dhe të sinqerta, ua bëra me dije synimin tonë për marrëveshjen me Serbinë, duke i dhënë fund armiqësisë mbi njëshekullore dhe duke

ruajtur stabilitetin në këtë pjesë të Ballkanit, por edhe qëllimin tonë për të thelluar edhe më tej bashkëpunimin dhe miqësinë me të gjitha vendet e rajonit.

Marrëveshja paqësore e bazuar në korrigjimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në rast se arrihet, do të jetë krejtësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Një marrëveshje e tillë, Kosovës i siguron njohjen formale nga Serbia, i siguron bashkëngjitjen e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës dhe i hapë rrugë të sigurt për anëtarësim në BE, NATO dhe OKB, duke forcuar kështu stabilitetin dhe mbyllur vatrën e fundit të konfliktit në Ballkan.

Prandaj, sceptikët e kësaj marrëveshjeje mund t'i siguroj që tani se nuk do të ketë korrigjim të kufirit përgjatë vijave etnike, nuk do të ketë eksod të popullsisë dhe as efekt domino sa i përket stabilitetit të kësaj ane të Evropës.

Për më tepër, kjo marrëveshje paqësore do të vendosë një gur të rëndësishëm mbi të ashtuquajturën "Kuti e Pandorës", e cila këto ditë po përfolet me shumë pasion. E nëse dikush patjetër argumenton dhe i referohet një marrëveshjeje eventuale të korrigjimit paqësor të kufirit si precedent, atëherë ky rast vërtet do të mund të përdorej në të ardhmen si një precedent pozitiv i domosdoshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërshtetërore vetëm në mënyrë paqësore dhe jo me luftë.

Koha e luftërave dhe konflikteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, për bindjen time, ka kaluar. Por, fundi i kësaj epoke do të konstatohet vetëm kur ta bëjmë marrëveshjen përfundimtare paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

## Zëvendësministri Ramadani: Tranzicioni i FSK-së, i sigurt dhe i pakthyeshem

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani, ka thënë të dielën se nuk ka vend për skepticizëm pasi, sipas tij, tranzicioni i FSK-së është i sigurt dhe i pakthyeshem. "Vendimi për procedimin e projektligjeve nga Qeveria për në Kuvendin e Kosovës nuk është as i

atypëratyshëm, as i ngutshëm dhe as i papërkrahje. E tëra bazohet në një punë jashtëzakonisht të detajuar, përpjekjeve të gjata, punë të përbashkët me partnerët strategjikë dhe planit të qartë dhjetëvjeçar. Prandaj, jemi në rrugë të sigurt. Pa asnjë dilemë. Kosova po kthehet gradualisht në kontribuues për sigurinë rajonale dhe

globale. Djemtë e vajzat e Kosovës do të jenë krah për krah me botën demokratike për ta siguruar paqen kudo nëpër botë. Rajoni ynë do të përfitojë nga tranzicioni i FSK-së. Qytetarët dhe komunitetet në Kosovë do të vazhdojnë ta kenë mbështetjen e FSK-së", ka shkruar Ramadani në llogarinë e vet në "Facebook".



## Sirianët votojnë në zgjedhjet lokale për herë të parë pas 7 vjetësh

DAMASK, 16 SHTATOR - Sirianët që jetojnë në zona të kontrolluara nga qeveria, kanë hedhur votën e tyre të dielën në zgjedhjet e para lokale që nga viti 2011, kur shpërtheu

kryengritja kundër udhëheqjes së presidentit Bashar al-Assad. Shtatë vjet nga votimet e fundit, konflikti ka lënë të vrrarë 360 000 persona, ka detyruar miliona të zhven-

dosen dhe ka shkatërruar ekonominë. Tani, trupat siriiane kanë kthyer kontrollin e rreth dy të tretave të shtetit, pas fitoreve kryesisht në Damask dhe Sirinë Jugore. Më shumë se

6 550 qendra votimi u hapën të dielën në zonat e kontrollit qeveritar. Më shumë se 40 000 kandidatë do të garojnë për 18 478 ulëse në këshillat lokale administrative.



# Paqja mes Izraelit dhe palestinezëve, më e largët në epokën Trump

Disa prej ekspertëve paralajmërojnë se përmes veprimeve të saj të fundit administrata Trump ka humbur besimin e palestinezëve për të qenë një ndërmjetës i drejtë në konfliktin me Izraelin

TEL-AVIV, 16 SHTATOR - Pesë vjet pasi Izraeli dhe Organizata për Çlirimin e Palestinës nënshkruan Marrëveshjen e Paqes të Oslos, e cila shtoi shpresat për një zgjidhje gjithëpërfshirëse, ekspertët thonë se paqja në Lindjen e Mesme është më larg se ndonjëherë. Disa prej ekspertëve paralajmërojnë se përmes veprimeve të saj të fundit administrata Trump ka humbur besimin e palestinezëve për të qenë një ndërmjetës i drejtë në këtë konflikt.

Shtërngimi i duarve mes kryeministrit izraelit Yitzhak Rabin dhe kryetarit të atëhershëm të OQÇ-së, Yasser Arafat, sfidoi tabutë e vjetra për çfarëdolloj bashkëpunimi mes dy armiqve, ndërsa të dyja palët i mbanin sytë nga ndihma e Shteteve të Bashkuara për të arritur një marrëveshje më të gjerë që do ta mundësonte bashkëjetesën paqësore të dy shteteve sovraane, Izraelit dhe Palestinës.

Tashmë, 25 vjet më vonë, administrata Trump ka kënaqur Qeverinë izraelite, por ka armiqësuar palestinezët nëpërmjet një sërë veprimesh, duke filluar me njohjen e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit dhe vendosjen atje të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara.

Gazetarët shtruan pyetjen nëse administrata Trump beson se po i inkurajon palestinezët të rikthehen në tryezën e bisedimeve nëpërmjet prerjes së fondeve për agjencinë e OKB-së për refugjatët palestinezë dhe mbylljes së zyrës së OQÇ-së në Uashington. Zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Heather Nauert, tha se zyrtarët amerikanë po provojnë një përqasje tjetër. "Asgjë nuk ka funksionuar gjatë gjithë jetës sonë, apo jo? Asgjë nuk ka funksionuar deri më tani, kështu që po provojmë një përqasje tjetër dhe të shohim nëse do të ketë rezultat.



Jemi të përkushtuar dhe kemi njerëz në terren, që punojnë çdo ditë për këtë gjë. Vazhdojmë të jemi optimistë dhe po punojmë", tha Nauert.

Dhëndri i presidentit, Jared Kushner, i tha gazetës "The New York Times" se asnjë nga masat ndëshkuese ndaj palestinezëve nuk i ka ulur shanset për një plan amerikan për paqen, përpjekje të cilën ai drejton. Por, disa analistë nuk janë dakord. "Këto lëvizje të administratës Trump ia kanë mbyllur derën mundësisë për t'i

angazhuar palestinezët në një mënyrë konstruktive. Janë një sërë vendimesh. U mor vendimi për të hapur ambasadën në Jerusalem; vendimi për të prerë fondet për UNRWA-n, programin palestinez të ndihmave për refugjatët; vendimi për ndihmën që i jepej autoritetit palestinez", thotë Natan Sachs, i Institutit Brookings.

Sachs vë në dukje se administrata Trump vazhdon të thotë se plani është pothuajse i përfunduar dhe se do të paraqitet së

shpejti. "Ky plan vazhdon të jetë gjithnjë gati për t'u publikuar. Nuk di nëse do të publikohet ndonjëherë. Pjesë të këtij plani janë pritur tashmë ftohtë nga disa udhëheqës arabë. U tha se po qarkullonin idenë për të përfshirë Jordaninë, diçka që jordanëzët e kanë përfshirë kategorikisht që në vitin 1988", thotë Sachs.

Për shumë banorë të kësaj pjese të botës, shpresat për një paqe të qëndrueshme janë venitur si një kujtim i largët.

## Kryebashkiaku i Londrës kërkon referendum të dytë për 'Brexit'-in

LONDËR, 16 SHTATOR - Kryebashkiaku i Londrës, Sadiq Khan, ka kërkuar një votim të ri për Brexit-in, duke kritikuar mënyrën sesi qeveria po adreson negociatat me BE-në.

Politikani laburist tha se, me Britaninë e Madhe që brenda 6 muajsh duhet të largohet nga BE-ja, rreziku që kanoset tani është ai i një marrëveshjeje të keqe apo të asnjë marrëveshjeje. "Debatimi aktual është përqendruar më shumë tek ambicjet politike të Boris Johnsonit, sesa tek ajo që është e mirë për Britaninë e Madhe", tha Khan.

Kryeministrja Theresa May ka thënë se një votim i dytë do të ishte tradhti për demokracinë. Ndërkohë, Khan, ish-deputet i zonës Tooting, tha se, edhe pse kishte bërë fushatë për qëndrim në BE, ai e ka pranuar vullnetin e britanikëve për të dalë nga unioni.

Ai shtoi se nuk e kishte menduar që do t'i mbështeste thirrjet për një referendum të dytë, por se është shqetësuar gjithnjë e më shumë për ecurinë kaotike të negociatave, që duket se janë zhytur në konfuzion dhe bllokim.



Me kohën për negociatat që po mbaron, Khan thotë se Britania e Madhe ka mbetur përpara dy

mundësive shumë të rrezikshme. "Të dy këta skenarë janë shumë larg asaj që u premtua

gjatë fushatës për referendumin dhe vetëm sa ekspozojnë gënjeshttrat dhe të pavërtetat që i janë shitur publikut", thotë ai. "Unë nuk besoj se Theresa May ka mandatin për të vënë të tilla baste me ekonominë britanike dhe jetët e njerëzve", tha ai. Më herët, Khan kishte thënë se ai besonte që publiku britanik duhej të konsultohet nëse Parlamenti do të votonte kundër marrëveshjes përfundimtare të qeverisë për "Brexit"-in. Por, të dielën ai tha se kishte arritur në përfundimin se populli duhej të thoshte fjalën e fundit.

## Zgjidhet kryetari i ri i Parlamentit irakian

BAGDAD, 16 SHTATOR - Parlamenti irakian ka zgjedhur ligjvënësin sunit Muhammad al-Halbusi si kryetar i Parlamentit derisa vendi po formon qeverinë e re pas mua-

jve të negociatave. Zgjedhja e Halbusit, shënoi fillimin e procesit që zgjat 90 ditë për finalizimin e Qeverisë. Halbusi, 37 vjeçar, do të jetë kryetari më i ri në historinë e

Parlamentit irakian. Ai u mbështet nga blloku pro-iranian i udhëhequr nga Aleanca Hadi-al Ameri, e ish-luftëtarëve paramilitarë. Posti i zëvendëskryetarit të

Parlamentit iu dha Hassan Karim, i cili u mbështet nga kleriku shi'it Muqtada al-Sadr, blloku partiak i të cilit fitoi numrin më të madh të ulëseve.



# POLLATA LEGJENDARE



**Ismet SYLEJMANI**

*E dashur dhe shumë e nderuar familja Munolli e Pollatës!*

*Të dashura dhe të nderuara familje të heronjëve të deshmorëve Besim Latifi dhe Skender Munolli!*


*Të dashur dhe shumë të nderuar familjarë të heronjeve dhe deshmorëve të Atdheut!*

*Të nderuar të pranishëm, veprimtarë, patriot ish - të burgosur politik, luftetarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, komandantë!*


Është knaqësi dhe nderë i madhë të flasësh në Pollatë përpara këtij vendi që është deshmi e gjallë e luftës dhe heroizmit të pashembullt të vitit 1990!

Është thënë dhe shkruar gjithmonë nëpër histori se çdo pëllëmbë e Atdheut tonë, është histori e madhe dhe e lavdishme!

Por ky vend këtu është histori që na ka mësuar dhe na ka bindur se lufta për lirinë e popullit shqiptar është e mundshme dhe çlirimi i Atdheut bëhet vetëm me luftë të armatosur!



**Besim Latifi**



**Skender Munolli**

Krahina e Llapit nga ky vend e ka marrë nismen e parë, se lufta kundra Serbisë bëhet me sukses

të madh por gjaku është e pashmangshme që të mos derdhet! Të gjithë dimë se viti 1990 është vit i madh, sepse Pollata e ka shkundur përgjithmonë nga gjumi popullin dhe politikanët pacifistë, sepse pa luftë të armatosur nuk bëhet e mundshme liria dhe pavarësia e popullit tonë!

Kësaj ngjarje dhe kësaj lufte të madhe këtu të Munollëve të lavdishëm, i ka paraprirë Çeta heroike e Llapit, i ka paraprirë gjaku i derdhur për liri i Ali Ajetit, i Bedri Sokoli, i Afrim Zhitisë dhe i Fahri Fazliut!

Ajo ka qenë pararendsja e bete-

jes këtu që është zhvilluar me pushkë e me bomba, me barut që është larë me gjak.

Gjaku i Besimit dhe gjaku i Skenderit, ka qenë vula përfundimtare, dhe është nisur fillimi i krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Hasan Ramandani është vazhduesi besnikë i heroizmit masiv të Munollëve.

Është e pashmangshme që të mos përmendet profesori i matematikës Isuf Latifi, i cili me laps dhe me ditarë përpara nxënseve i ka braktisur ato dhe ka kapur pushken e luftës për liri, dhe lufta e Ushtrisë Çlir-

imtare të Kosovës, këtu në këtë vendë ka pasur kuptim më shumë se kudo, sepse e ka lidhur Demë Ahmetin dikur, e ka lidhur follenë e të burgosurve politikë ku ka qendruar edhe Metush Krasniqi këtu, e ka vazhduar me luftën heroike të Munollëve, kjo ngjarje e 28 viteve që koincidon me ditën sot dhe ditën atëherë, neve na obligon shumë!

Munollëve dhe Pollatës, populli shqiptar jo vetëm që duhet t'iu përulet përgjithmonë, por edhe ju ka borgj!

Lavdi e përjetshme!

Nderë dhe Lavdi përgjithmonë!



Pollatë, 13 shtator 2018




**ME SHQIPTARËT E AMERIKËS  
BASHKIM LATIFI**



**AA VISION  
NDEROHET 28 VJETORI I RËNJES HEROIKE TË  
HERONJËVE BESIM LATIFI DHE SKENDER MUNOLLI**

**FJALIM I ISH-ANËTARIT TË KOMITETIT DREJTUES  
TË LPRK-SË ISMET SYLEJMANI**

(Në përvjetorin e rënies së dëshmorëve të kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi)

# Trimat e Pollatës janë pjesë e lirisë sonë kombëtare



Prof. dr. Nusret PLLANA  
/Universiteti "Hasan Prishtina"  
Prishtinë

## Përkufizimi

Historia e të gjithë popujve të botës, andaj edhe historia e popullit shqiptar, ndërtohet mbi bazë të shëmbëllimeve. Çka do të thotë kjo?

Do të thotë, secili dëshmor i kombit ka mësuar nga të parët e tij si të vdiset për lirinë e atdheut. E atdheu është vetëm një - Shqipëria. Ky atdhe, një pjesë të geografisë së tij e kishte të pushtuar kurse, po ashtu, një pjesë e popullit shqiptar ishte i robëruar.

Prandaj, trimat e Pollatës, dëshmorët e kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi, kishin mësuar shkollën e luftës për lirinë e atdheut nga të parët e tyre, nga stërgjyshi e gjyshi, nga xhaxhallarët e nga babai.

## Hyrje

Sa herë liria e atdheut i thërriste në vijat e frontit, trimat e Pollatës me ato armë që kishin, ishin në istikame. Sa herë, duhej t'i dëshmohej pushtuesit të kësaj pjese të atdheut, ata bënë veprime, të cilat pushtuesi me argatët e tij, i dënonte, i burgoste, i vriste, qoftë në pritë, qoftë në kurthe, qoftë edhe ballë për ballë.

dëshmorët e kombit që po i përkujtojmë sot, Skender Munolli e Besim Latifi, ishin rritur, ishin edukuar dhe ishin burrëruar me këtë frymë kombëtare, që të mos e duronin pushtuesin të bënte çka të donte me familjet e tyre, me bashkëqytetarët e tyre, me bashkatdhetarët e tyre.

Jo rastësisht, andaj, duhej pushka e tyre që në vitet e nëntëdhjetë, që të mësohej e të dëgjohej, anë e mbanë tokave të atdheut arbëror, se një pjesë e këtij atdheu ishte e pushtuar. Andaj, duhej rënia e tyre në altar të lirisë, që të bëheshin më vonë shkollë e madhe e të gjithë dëshmorëve të kombit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Andaj, duhej rënia e tyre në altar të lirisë, që të bëheshin më vonë shkollë e madhe e të gjithë dëshmorëve të kombit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## Shkolla e madhe e luftës për lirinë e atdheut

dëshmorët e kombit që po i përkujtojmë sot, Skender Munolli dhe Besim Latifi ishin rritur dhe ishin edukuar, përveç të tjerash, edhe

duke vizituar prindërit e tyre, xhaxhallarët e tyre, të afërmit e tyre, nëpër burgjet e pushtuesit të tokave shqiptare, nëpër burgjet e Serbisë, e cila fshihej pas parullës së vëllazërim - bashkimit.

Po ashtu, ata ishin rritur dhe ishin edukuar, edhe me krismën e pushkës së të parëve të tyre, edhe të baballarëve të tyre, kundër pushtuesit, që shtihej se na kishte vëllezër, që shkruante nëpër libra, se ne ishim sllavë, se atdheu ynë ishte ish-Jugosllavia.

Këtë shkollë të madhe të luftës për lirinë e atdheut, dëshmorët e kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi e kishin mësuar edhe nga historia e popullit shqiptar.

Një histori shumë tragjike, por edhe madhështore. Dija e historisë na mëson se vetëm ngjarjet tragjike janë madhështore.

Nuk ka asgjë më madhështore se ngjarja historike e Pollatës e 13 shtatorit të vitit 1990, kur forca të shumta të një shteti, që ishte pushtues i tokave shqiptare, kishte rrethuar me tërë arsenalin e armatimit, një lagje, një fshat të tërë, duke shpresuar se ata do të dorëzoheshin dhe do të bëheshin argat të dreqit, siç i quante ata që punonin me pushtuesin, legjenda e luftës për lirinë tonë, Bacë Adem Demaçi.

Duhej pushka e dëshmorëve të kombit Skender Munolli e Besim Latifi, që armiku ynë historik, Serbia pushtuese, të mësonte se shqiptarin mund ta vrasësh, por nuk dorëzohet.

Dëshmorët, që po i përkujtojmë sot, Skender Munolli dhe Besim Latifi, duke bërë përpjekje të çanin rrethimin bien në altar të lirisë, të cilën liri e gëzojmë sot. Dhe, për çudi, liria vjen për të gjithë, edhe për ata që kishin qenë argat të dreqit.

## Pushkët që u bënë shenja të lirisë sonë


Po rrethohej një lagje. Po rrethohej një fshat, Pollata, e cila ishte bërë shenjë e kujtesës sonë kombëtare, qoftë kur dënoheshin me shumë vjet burgje, paraardhësit e dëshmorëve të kombit ngaqë ata, qoftë se ishin pjesëtarë të organizatave të ndryshme ilegale liridashëse, që përpiqeshin për lirinë e atdheut, qoftë kur u shpjegonin fëmijëve në shkollë se atdheu ynë është Shqipëria, qoftë kur bëheshin pjesë e veprimeve ushtarake ilegale. Ky ishte shkaku i rrethimit të një fshati. Ky ishte edhe argumenti që kishte përdorur pushtuesi ynë, Serbia fashiste e asaj kohe, kur kishte rrethuar Pollatën, në mbrojtje të të cilit kishin rënë edhe dëshmorët e kombit që po i përkujtojmë sot, në 28-vjetorin e rënies së tyre heroike, Skender Munolli dhe Besim Latifi.

Një nga atdhetarët e këtij fshati, Avdi Munolli, kishte bërë sa herë burgje ngaqë ishte veprimtar i çështjes kombëtare. Burgje kishte bërë edhe Hashim Munolli ngaqë e

kishin akuzuar për vrasjen e një qytetari serb.

Burgje kishin bërë edhe veprimtarë të tjerë të Pollatës. Prandaj, pushkët që krisën atë ditë shtatori të vitit 1990, erdhën dhe u bënë shenjat e para të pushkëve të luftës për lirinë e kësaj pjese të atdheut të robëruar.

Dëshmia më e mirë e këtyre shenjave, dëshmia më e saktë se ato pushkë ishin krisma të luftës për liri, ishte edhe varrimi 'madhështor' i dëshmorëve të kombit,



Besim Latifi



Skender Munolli

Skender Munolli dhe Besim Latifi. Ata, nuk e kishin afër pjesën më të madhe të familjarëve, të afërmit dhe të largët, ngase ishin burgosur mbi tetëdhjetë (80) banorë të asaj lagje, por ata ishin bërë pjesë e dhembjes dhe të krenarisë të një familje të madhe, të familjes së kombit shqiptar. Ndryshe, nuk mund të shpjgohet fakti se atë ditë, në varrimin e dëshmorëve të kombit Skender Munolli dhe Besim Latifi, kishin ardhur mbi pesëdhjetë mijë shqiptarë (50 mijë), nga të gjitha anët e geografisë sonë kombëtare. Askush nuk mund ta thotë me siguri se nga kishin ardhur, si kishin ardhur, nëpër cilat rrugë dhe nëpër cilat shtigje kishin ecur, nëpër cilat male dhe nëpër cilat fusha kishin udhëtuar, kohë e pa kohë, me bukë e pa të, të etur dhe të pikëlluar.

Por, ata kishin ardhur që të bëheshin pjesë e familjes së madhe të dëshmorëve të kombit, të cilët kishin rënë në përballje me pushtuesin e tokave shqiptare. Ata kishin ardhur, edhe për të nderuar kujtimin dhe luftën e dëshmorëve të kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi, por edhe t'i thoshin banorëve të Pollatës, se ata ishin pjesë e familjes së madhe të kombit shqiptar.

Pjesë të familjes së Munollëve edhe mund të ishin në burg, pjesë të familjes edhe mund të mos lejoheshin të merrnin pjesë në varrimin e djemve të tyre, të nipave dhe vëllezërve të tyre, të trimave të tyre, por asnjë pushtues nuk mund të mbyllte rrugët e një kombi të tërë që të bëhej pjesë e familjes së Munollëve të Pollatës, atë ditë kur kishin rënë dëshmorët e kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi.

Qoftë edhe vetëm ky fakt, dësh-

mon se rënia e Skender Munollit dhe e Besim Latifit, pushka e tyre e lirisë, ishte shenjë e Luftës së ardhshme çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lufta për lirinë e atdheut është përjetësia e dëshmorëve të kombit

Historia e të gjithë popujve historik të botës, ndërtohet mbi shenjat që krijojnë brezat e atyre popujve në përpjekje për lirinë e vendit. Edhe historia e popullit

për lirinë dhe çlirimin e atdheut, ishte bërë pjesë e edukatës dhe e vetëdijes kombëtare edhe e dëshmorëve të kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi, që po i përkujtojmë sot.

Duke i përkujtuar të rënë për lirinë tonë, ne dhe brezat që do të vijnë pas nesh, do të kenë shenjat e përjetshme ku të mësojnë dashurinë ndaj lirisë, dashurinë ndaj çlirimit, dashurinë ndaj atdheut.

Qoftë edhe vetëm për këtë fakt të vogël, dëshmorët e kombit që po i përkujtojmë sot, Skender Munolli dhe Besim Latifi, janë pjesë e përjetësisë së kujtesës sonë kombëtare, pa të cilën as nuk mësohet shkolla për ta ruajtur lirinë e atdheut, as nuk mësohet shkolla e sakrificës për çlirimin e atdheut.

## Përfundim

Sot, në përvjetorin e rënies së tyre, në përvjetorin e sakrificës sublime për lirinë tonë, të dëshmorëve të kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi, ne të gjallët që do të kemi vdekje të zakonshme, mësojmë se përjetësia ju takon vetëm atyre që kanë dhënë jetën për lirinë e atdheut.

Mësojmë se rënia e tyre është bërë shkollë e jetës së popullit shqiptar, edhe për faktin se me rënie të tyre, ata janë bërë pjesë e kujtesës sonë kombëtare, e cila deri me rënie të tyre kjo pjesë e atdheut, këtë të drejtë të tyre legjitime e kishte të ndaluar.

Nuk ka pushtim më tragjik, se sa kur brezave të tërë të një populli, ju ndalohet të shkojnë në varrimin e atyre që kanë rënë për liri. Por, siç e dini edhe ju të gjithë, i madh e i vogël, plak dhe i ri, në shtatorin e vitit 1990, kur kishin rënë dëshmorët e kombit, Skender Munolli dhe Besim Latifi, shqiptarët e kishin mundur ndalesën tragjike, i kishin mundur urdhrat e pushtuesit, e kishin mundur frikën thaujse shekullore dhe kishin ardhur t'u japin lamtumirën e fundit të rënëve për lirinë tonë, Skender Munollit dhe Besim Latifit.

Lavdi dëshmorëve të kombit Skender Munolli dhe Besim Latifi! Lavdi të gjithë Dëshmorëve të Kombit që kanë rënë për lirinë tonë!

Prishtinë-Pollatë, 13 shtator 2018



## Aktorja e famshme bën ushtrime fizike me djalin e porsalindur



**A**ktorja e famshme Eva Longoria solli në jetë fëmijën e parë Santiago Enrique në qershor. Por, kjo nuk e ka ndaluar aktoren t'i kushtojë kohë vetes. Ylli i Hollywoodit është fotografuar duke bërë ushtrime


fizike me të voglin e saj në një park të Gold Coast. 43-vjeçarja mban djalin në krahë dhe ushtrohet në natyrë. Eva shihet e veshur me kostum sportiv të zi dhe tepër e relaksuar derisa shijon çdo çast me Santiagon.

## Iggy Azalea e quan dembel Eminemin



**K**ëngëtarja e famshme Iggy Azalea e ka quajtur dembel reperin Eminem pas lansimit të këngës diss "Killshot". Eminem i referohet si prostitutë Azaleas tek kënga "Killshot" që ishte një dis për reperin Machine

Gun Kelly. Sigurisht se kjo nuk i ka pëlqyer Iggyt dhe ajo i është përgjigjur reperit përmes rrjetit social në "Twitter". Ajo ka pohuar se një këngë nuk duhet të jetë e mbushur me emra të të famshmëve.



## Pas ndarjes nga ish i dashuri, Kourtney kapet me një model të ri

**K**ourtney Kardashian është fotografuar e veshur me një fustan ngjyrë hiri i cili vezullonte derisa ishte drejtuar për një darkë me një mik në Los Angeles. Nëna e tre fëmijëve ishte e shoqëruar nga aktori dhe mod-

eli me emrin Sabbat. Kjo vjen vetëm pak javë pasi Kourtney u nda nga ish i dashuri i saj, Younes Bendjima. Çifti ishte në lidhje për më shumë se një vit. Sipas raportimeve të fundit, 39-vjeçarja u nda nga i dashuri pasi ai e tradhtoi.

## Justin Bieberi është martuar fshehurazi me Hailey Baldwin

**J**ustin Bieberi raportohet se nuk është më një djalë beqar. Mediat raportojnë se ylli i muzikës pop është martuar me modeluesen Hailey Baldwin. Revista "People" shkruan se çifti ka lidhur nyjën para një gjykatësi në Nju Jork. "Ata çuan marrëdhënien e tyre përpara pa dëgjuar askënd", ka një burim i afërt i çiftit, që u fejuan në muajin korrik.



# KORREKTËSIA POLITIKE

## Intervistoi: Maite RICO

Laureati i Nobelit, përveçse shkruan fikcion, lufton palodhshëm për liritë civile. Në librin e ri, "Thirrja e fisit", promovon mendimin liberal dhe nderon shtatë autorë që mbrojnë liritë civile. Kemi folur me të për liberalizmin, verbërinë intelektuale dhe rreziqet me të cilat sot po përballlet demokracia.

Mario Vargas Llosa është në formë të mirë. Laureati peruan i Nobelit qeshet lehtas derisa shtjellon teoritë e tij për lirinë dhe individin, dhe flet për librin e ri, "La lamada de la tribu" ("Thirrja e fisit"), ku argumenton në favor të mendimit liberal, duke iu referuar shtatë autorëve të njohur me ndikim: Adam Smith, José Ortega y Gasset, Friedrich von Hayek, Karl Popper, Raymond Aron, Isaiah Berlin dhe Jean-François Revel. Këta burra i përkasin një shkollë mendimi që beson në individin si qenie autonome dhe e përgjegjshme, dhe në lirinë si aset i suprem. Ata mbrojnë demokracinë dhe ndarjen e pushteteve si sistemi më i mirë i mundshëm për t'i ujdur vlerat kundërthënëse të shoqërisë. Ata mishërojnë doktrinën që refuzon "frymën tribale" që historikisht i ka dhënë zemër fashizmit, komunizmit, nacionalizmit dhe fanatizmit fetar. "Thirrja e fisit" është edhe autobiografi intelektuale që e çon lexuesin prej fillimeve esencialiste dhe marksiste të Vargas Llosës deri te mbështetja e tij për liberalizmin.

**El Pais:** Pse po sulmohet kaq shumë mendimi liberal?

**Llosa:** Është shënjestruar prej ideologjive që janë armike të lirisë dhe që justifikueshëm e konsiderojnë liberalizmin armikun më këmbëngulës. Dhe, këtë kam dashur ta shtjelloj në libër. Fashizmi dhe komunizmi kanë sulmuar fuqishëm liberalizmin, duke e lidhur dhe krahasuar keq, kryesisht me konservatorizmin. Në fillimet e veta, liberalizmi ishte rrethuar kryesisht prej të djathtës. Ishte sulmuar prej gjuhës papale - kishte sulme të klerit kishtar gjithkund kundër një doktrine që konsiderohej armike e religjionit dhe e vlerave morale. Mendoj se këto hasmëri përcaktojnë lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet liberalizmit dhe demokracisë. Demokracia ka çarë përpara dhe të drejtat e njeriut janë njohur kryesisht falë mendimtarëve liberalë.

**El Pais:** Të gjithë autorët që i analizoni në libër notonin kundër rrymës.

**Llosa:** Hayekut dhe Ortegës

madje ua ndaluan dy libra. A janë liberalët të dënuar të ecin vetëm? Liberalizmi nuk mjaftohet vetëm me përqafim të një fryme. Ai, në fakt, edhe nxit ndryshimin. E pranon se shoqëria përbëhet prej sojeve të ndryshme të njerëzve, dhe është me rëndësi të lihet rehat ashtu. Nuk është ideologji; ideologjia është religjion shekullar. Liberalizmi mbron disa ide themelore: lirinë, individualizmin, refuzimin e kolektivizmit dhe nacionalizmin - me fjalë të tjera, krejt ideologjitë a doktrinën që kufizojnë ose tëhuajësojnë lirinë brenda shoqërisë.

**El Pais:** Kur po flasim për nacionalizmin, Ortega y Gasset ka folur shumë për rreziqet e nacionalizmit në "Vendi bask dhe Katalonja". Pse liberalët refuzojnë nacionalizmin?

**Llosa:** Sepse nuk përputhet me lirinë. Mjafton t'ia gërvishtni sipërfaqen për ta parë se nacionalizmi përfshin njëfarë racizmi. Nëse besoni se t'i përkasësh një shteti a kombi të caktuar, race a religjioni të caktuar, është vlerë në vetvete, atëherë ju besoni se jeni superior ndaj të tjerëve. Dhe racizmi shpie pashmangshëm drejt dhunës dhe shtypjes së lirisë. Kjo është arsyeja pse liberalizmi nga koha e Adam Smithit ka shquar këtë soj kolektivizmi në nacionalizëm - refuzimin e arsyes për një akt besimi.

**El Pais:** Po populizmi, ringjallja e nacionalizmit, Brexit... a po rilind tribalizmi?

**Llosa:** Ka një trend që nuk shkon me atë çfarë unë e konsideroj të jetë zhvillimi më përparimtar i kohës sonë - formimi i entiteteve të mëdha që ngadalë po heqin qafe kufijtë dhe po inkorporojnë gjuhët, zakonet dhe bindjet e ndryshme, sikur se po ndodh në Evropë. Ky zhvillim nxit shumë pasiguri dhe paqartësi, dhe joshje të madhe për rikthim kah fisi, kah shoqëria e vogël homogjene që asnjëherë nuk ka ekzistuar, ku gjithsecili është i njëjtë, ku të gjithë kanë bindje të njëjta dhe flasin gjuhë të njëjtë. Është mit që gjeneron siguri të madhe dhe që shpjegon revoltat, si Brexit, nacionalizmi katalan ose soji i nacionalizmit që bën kërdi brenda demokracive, siç po ndodh në Poloni, Hungari, madje edhe në Holandë. Nacionalizmi është i pranishëm, por kam përshtypjen se, siç po ndodh në Katalonjë, është pakicë, dhe se fuqia e institucioneve demokratike do ta minojë ngadalshëm deri në shkallën e përmbytjes. Jam goxha optimist në këtë pikë.

**El Pais:** Kapërcimi juaj prej marksizmit në liberalizëm është i pazakonshëm. Në fakt, është i

njëti shteg që kanë rrahur disa prej autorëve që i analizoni, si Popperi, Aroni dhe Reveli.

**Llosa:** Brezi im në Amerikën Latine çoi arsyeshëm krye në një kontinent të pabarazive përbindëshe dhe diktaturave ushtarake, të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe për një riosh latinoamerikan, disi të shqetësuar, ishte e vështirë ta refuzoje këtë karikaturë të demokracisë. Doja të bëhesha komunist. Mendoja se komunizmi përfaqësonte antitezën e diktaturës ushtarake, e korrupsionit dhe, para së gjithash, antitezën e pabarazisë. E nisa në Universitetin Kombëtar të San Marcos me idenë se atje do të kishte komunistë me të cilët mund të përzihesha. Dhe aty i gjeta. Por, komunizmi në Amerikën Latine ishte stalinizëm i pastër, me parti që i nënshtroheshin Kominternit në Moskë. Isha militant vetëm vitin e parë, pastaj vazhdova të isha një socialist me njëfarë fryme më të relaksuar, një qëndrim i fuqizuar prej revolucionit kuban, që në fillim dukej socializëm ndryshe, më pak dogmatik për nga stili. Isha entuziast. Në vitet shtatëdhjetë shkova pesë herë në Kubë. Por, ngadalë, nisa t'i hiqja qafe iluzionet, sidomos pas krijimit të UMAP-it - Njësiteve Ushtarake për Ndhimë Prodhimit. Bastiseshin të rinjtë që i njihja. Ishte traumatike. Dhe mbaj mend se i shkrova një letër private Fidel Castros, ku i shprehja pakënaqësinë dhe e pyesja se si Kuba, që dukej se kishte një socializëm tolerant dhe të hapur për nga stili, mund t'i fuste "krimbat" dhe homoseksualët në kampe përqendrimi krahe krahe me kriminelët. Fideli më ftoi mua dhe një numër intelektualësh që të flisnim me të. E kaluam tërë natën, 12 orë, prej tetë të darkës deri në tetë të mëngjesit, në fakt duke dëgjuar atë teksta fliste. Ishte diçka mbresëlënëse, por jo bindëse. Prej asaj dite, nisa të hidhja dyshime. Thyerja e madhe erdhi përfundimisht me rastin Padilla, kur shkrimtari Heberto Padilla, burgosur më 1971, u detyrua ta poshtëronte veten publikisht, duke shënuar fundin e një raporti idilik ndërmjet intelektualëve të rëndësishëm dhe regjimit kuban. Kalova nëpër një proces të gjatë dhe të vështirë, përqafova demokracinë dhe lëvizja ngadalë drejt doktrinës liberale - isha mjaft me fat që jetova në Britani gjatë viteve të Margaret Thatcherit.

**El Pais:** Portreti që ia pikturon Margaret Thatcherit si grua e guximshme dhe e kulturuar, grua e bindjeve të thella liberale, është në kundërshtim të madh me imazhin që ne këtu e kemi për të.



**Llosa:** Ky është një shtrembërim absolutisht i padrejtë. Kur mbërrita në Angli, ishte vend dekadent - një vend me liri, por karakteri i të cilit po digjej ngadalshëm prej nacionalizmit ekonomik të Partisë Laburiste. Revolucionari i Margaret Thatcherit zgjoi Britaninë. Ato ishin kohë të vështira; duke i dhënë fund strolçullit të sindikatave tregtare, duke krijuar shoqëri kompetente të tregut të lirë dhe duke mbrojtur demokracinë me bindje, njëherësh duke u përballur me socializmin, Kinën, Bashkimin Sovjetik - diktaturat më të vrazhda në histori. Ato ishin vite vendimtare për mua, sepse nisa ta lexoja Hayekun dhe Popperin, dy autorët e cituar nga Thatcheri. Ajo tha se "Shoqëria e hapur dhe armiqte e saj" do të ishte libër qenësor për shekullin njëzetë. Kontributi i Thatcherit dhe Ronald Reaganit për kulturën e lirisë, prishjen e Bashkimit Sovjetik - sfida më e madhe me të cilën është përballur ndonjëherë kultura demokratike - është realitet që, fatkeqësisht, është portretizuar keq në median e ndikuar prej një fushate të së majtës, arritjet e së cilës janë të vogla.

**El Pais:** Dhe cila është tani sfida më e madhe për demokracinë perëndimore?

**Llosa:** Armiku më i madh i saj tani është populizmi. Askush me mendje të shëndoshë nuk e dëshiron për vendin e vet modelin e Koresë Veriore, Kubës ose Venezuelës. Marksizmi është tashmë në periferi të jetës politike, por kështu nuk mund të thuhet për populizmin, që shkatërron demokracinë nga brenda. Larg më i drejtpërdrejtë se një ideologji, populizmi është tendencë që mund t'i ekzpozohen demokracinë e brishta.

**El Pais:** Kriza bankare e vitit 2008, ajo që përshkallëzoi pabarazinë, ka ringjallur kritikën kundër doktrinës liberale, duke iu referuar shpesh edhe si neoliberalizëm.

**Llosa:** Nuk di çka është kjo gjë që ata e quajnë neoliberalizëm. Është njëfarë mënyre e shtrembërimit të liberalizmit dhe e paraqitjes së tij si formë e pashpirt e kapitalizmit. Liberalizmi nuk është dogmatik, nuk e ka përgjigjen për gjithçka. Është zhvilluar që prej kohës së Adam Smithit deri tani, meqë edhe shoqëria po bëhet përherë e më e ndërlikuar. Sot ka padrejtësi, si



# ËSHTË ARMIKU I LIRISË



diskriminimi kundër grave, që në të kaluarën as që ishte përmendur.

**El Pais:** *Ndryshimi kryesor ndër-mjet niveleve të liberalizmit është roli i shtetit.*

**Llosa:** Po. Liberalët duan një shtet efektiv, por jo asi që përzihet gjithkund; një shtet që garanton liri dhe mundësi të barabarta, sidomos në shkollim dhe në aspektin e ligjit. Por, përtej këtij konsensusi, ka dallime. Isaiah Berlin thekson se liria ekonomike nuk mund të jetë e pakufizuar, sepse kjo qasje kishte bërë që fëmijët të ngujoheshin në miniera në shekullin nëntëmbëdhjetë. Hayek, në anën tjetër, kishte njëfarë besimi të jashtëzakonshëm në treg, sa që besonte se tregu mund t'i zgjidhë të gjitha problemet nëse do t'i lireshin duart krejtësisht të lira. Berlini ishte larg më realist. Ai besonte, në fakt, se tregu ishte ai që solli përparim ekonomik, por nëse përparimi nënkupton krijim të pabarazisë së tillë të madhe, atëherë ai rrezikon thelbin e demokracisë. Njëherësh, Adam Smith, i cili konsiderohet babai i liberalizmit, ishte shumë fleksibil. Afërmendsh se ka çarje të

liberalizmit. Ta zëmë, ka ekonomistë që janë krejtësisht mendjengushtë, të bindur se vetëm reforma ekonomike mund të sjellë liri të pashmangshme. Nuk pajtohem. Ma ha mendja se idetë janë më të rëndësishme se reforma ekonomike. Por nëse i kthehemi shtrembërimit ose hileve të gjuhës, përdorimi i etiketimit "progresiv" është shumë i rëndësishëm; në Spanjë është përdorur për t'i përshkruar forcat që mbrojnë diktaturat në Kubë dhe Venezuelë. Besoj se, fatkeqësisht, ky është kontribut i intelektualëve të shtrembërimit të gjuhës. Ata e kanë injektuar me prestigj marksizmin dhe komunizmin, siç ishte vepruar më parë me nazizmin dhe fashizmin. Qorrazi, intelektualët gjithnjë e kanë parë demokracinë si sistem mediokër që i mungonte bukuria, përsosmëria dhe koherenca e ideologjive të mëdha. Dhe kjo verbëri nuk është e papërputhshme me inteligjencën e jashtëzakonshme. Si mund të ishte nazist, ta zëmë Heideggeri, mbase filozofi më i madh në kohën moderne? E njëjta ka ndodhur edhe me komunizmin. Joshi shkrimtarë dhe poetë të mëdhenj, që kishin përkrahur

Gulagun. Sartre, filozofi më inteligjent francez i shekullit njëzetë, mbështeti Revolucionin Kulturor në Kinë.

**El Pais:** *Sartre justifikoi gjenocidet dhe mbështeti regjimet tiranike, dhe u fërkua me nazistët, derisa të tjerët, si Albert Camus, rrezikuan jetën e tyre në Rezistencë. Dhe pastaj ai mbajti leksione. Pse vazhdoni ta mbroini edhe tash?*

**Llosa:** Paj, mirë, ai ishte pjesë thelbësore e adoleshencës sime.

**El Pais:** *Ju e quani intelektual i madh, por ai ishte një burrë, politikë dhe të cilin gjithnjë janë vënë në dyshim.*

**Llosa:** Ai nuk ishte anëtar i vërtetë i Rezistencës - madje ishte pajtuar që të zëvendësonte një mësimdhënës që ishte larguar vetëm pse ishte hebre. Ai i përkiste një pjese të Rezistencës që nuk ishte veçmas aktive dhe, ma merr mendja, se ai asnjëherë nuk e kapërceu kompleksin që ia krijoi kjo situatë, dhe tërë jetën e kaloi duke bërë përpjekje, disa prej të cilave ishin groteske, për të fituar epitete si "progresiv" dhe "përparimtar". Ishte nevojë e madhe e kohës së tij - intelektualët donin ta kalonin testin përparimtar, sepse kjo ishte

pritur prej tyre. Në Amerikën Latine në vitet gjashtëdhjetë, nëse nuk ishte intelektual majtist, thjesht nuk ishte intelektual. Ta mbyllnin gojën. Kultura kontrollohej prej të majtës që ishte shumë klanore dhe dogmatike, dhe që kishte efekt të madh nënshtrues mbi jetën kulturore. Mendoj se kjo ka ndryshuar konsiderueshëm.

**El Pais:** *Kjo ndodhi edhe në Evropë*

**Llosa:** Afërmendsh. Megjithëse gjatë kohës sime në Angli atje kishte intelektualë që nuk kishin kompleksin e inferioritetit dhe që dolën hapur e luftuan, duke më ndihmuar edhe mua që të isha i çiltër me veten.

**El Pais:** *Është çështje e ndershmerisë intelektuale.*

**Llosa:** Elitat që mbrojnë regjimet, asnjëherë nuk do të futeshin në një thes me to... Bertrand Russeli, ta zëmë, mbrojti kauza shumë fisnike dhe ishte person i admiruar për shumë arsye, njëherësh mbrojti gjëra të frikshme dhe lejoi veten të manipulohej nga e majta, që nuk kishte kurrfarë respekti për krijimtarinë ose idetë e tij, as që ia kishte lexuar veprat. Si

mund ta shpjegoni kundërthënien? Fatkeqësisht, inteligjenca nuk është garanci e ndershmerisë intelektuale.

**El Pais:** *A duhet ta respektojmë krijimtarinë e një maskarai?*

**Llosa:** Jo vetëm se duhet ta respektojmë, por ajo krijimtari duhet të botohet. Nëse nisni ta gjykoni letërsinë me terme morale dhe etike, ajo jo vetëm do të shkatërrohej, por do të zhdukej krejtësisht - do ta humbiste *raison d'être* e saj. Letërsia shpreh çfarë realiteti mundohet ta fshehtë për një mori arsyes. Kurgjë nuk e stimulon frymën kritike në shoqëri më mirë se letërsia. Por, letërsia dhe moraliteti nuk shkojnë së bashku. Janë armiq. Dhe duhet ta respektoni letërsinë nëse besoni në liri.

**El Pais:** *A e kërcënon korrektësia politike lirinë?*

**Llosa:** Korrektësia politike është armiku i lirisë, sepse s'e pranon ndershmerinë dhe autenticitetin. Duhet ta sfidojmë si shtrembërim të së vërtetës.

**El Pais:** *Së fundi, shprehja "fake news" ka marrë hov si të ishte diçka e re.*

**Llosa:** Shprehje të reja për realitete të vjetra. Në rastin e dezinformimit dhe manipulimit, komunizmi ishte jashtëzakonisht i zgjuar për shtrembërime gjërash, duke minuar njerëzit e ndershëm dhe maskuar rrenat me të vërteta të rrejshme që zëvendësonin realitetin.

**El Pais:** *Bashkimin Sovjetik e ka marrë kahe të pusi, por tani kemi një soj të ri të përzierjes kibernetike nga Moska, që thuhet se ka prekur zgjedhjet amerikane, zgjedhjet katalane dhe fushatat zgjedhore në Meksikë dhe Kolumbi.*

**Llosa:** Ajo çfarë po shohim është një revolucion teknologjik që më shumë po shtrembëron kursin e demokracisë sesa po e fuqizon. Është teknologjia që mund të përdoret për qëllime të ndryshme, por të cilën armiqët e demokracisë dhe të lirisë po e përdorin për qëllimet e veta. Është një realitet me të cilin duhet të përballemi por, fatkeqësisht, unë besoj se ne kemi mjete të kufizuara për të vepruar. Bombardohemi me teknologji që është përdorur për t'iu shërbyer rrenave dhe post-të vërtetave, dhe të cilat mund të bëhen, nëse nuk e përtheqojmë fenomenin, jashtëzakonisht destruktiv, duke korruptuar civilizimin, progresin dhe të vërtetën demokratike.

(Marrë nga numri i tretë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")



Bujar MEHOLLI

# Balada e Anës

Po ecja poshtë rrugës,  
në një mbrëmje të këndshme  
me rreze hëne.  
Dhe mora kthesën që të shpie  
tek një kuplara...  
Desha të bëj qejf. U futa brenda.  
M'u renditën nja dhjetë vajza,  
secila më e bukur  
dhe më e pashme se tjetra.  
Për ta zgjedh një të  
që do ma bënte parajsë mbrëmjen,  
ia lash zemrës;  
zgjodha një bjonde mahnitëse,  
meflokësitë Alberht Dyrerit,  
dheftyrensitë Ana-Maria Montit.  
Mendojasi do ta gudulisningjoksintim  
atoflokë, e do mbesjazgjuar  
duke i ledhatuarterënatën...  
Edhevajasakaq, m'uduk se mori  
pamje të gëzuar, kur e zgjodha.  
Ngadalëu futëm në dhomë.  
Binte erë e keqe teksa vareshin shtrembër  
njadypikturanudotë Modiglianit.  
Një dritëndriçontekrejzbehtë,  
e zemra m'rrihte fortë;  
vura një disk xhaz, për ta bërë  
sa më madhështorë seksin.  
U zhveshëm, por vajza filloi të qajë me ngashërim  
teksaflakutëmbathuratatje-tej me nervozizëm.  
Ç'gjinjt'bukur, sidyfrutatëarrirë - mendova,  
pors'kuptojaç'ngjante.  
Iuafrova. E putha.  
Mëlejoit'ikalojëdorënnëpërflokët,  
përtëcilatëndrrojadëshpërimisht.  
Ishinaqtëbutë, simëndafshkinez.  
Ana, (kështu e quanin) me gjasës'kishpasëklientësiunë,  
dhepëratëderdhtelotëngazëllimi.  
Dhe ta mendosh se kësajhyjnie,  
iabëninatëpunënpleqtëbarkmëdhenjë,  
teksashihnikëtoflokëtëshpupurishuranëjastëk...  
U acarova nga ky mendim, ia kapa duart, e ledhatova.  
- Dëgjo, më tha. E vëreja se jeni njeri i mirë,  
andaj desha t'ua hap zemrën time t'plagosur.  
Nëse m'dëgjoni, do t'u dhurojë një natë të paharruar,

por edhe nëse s'më dëgjoni...  
I premtova se do ta dëgjoja pa frymë.  
- Kur isha e vogël, nisi - familja më përbuzte.  
Më vdiq nëna e re, babai s'na deshi kurrë.  
Bukuria më kushtoi shtrenjtë. Kur fillova t'rritem,  
babai me vëllezërit më detyruan në rrugë të dal,  
dhe çfarëdo pune të gjej...  
Dola.  
Ngacmimet më vinin nga të katër anët.  
Secili që në rrugë hasa, deshi në shtrat të më shtrijë,  
shoqëri kurrë nuk gjeta. Familja më mori në qafë!  
Në moshën 16-vjeçare bëra dashuri për herë të parë,  
me një djalosh rrugë, në bodrumin e një ndërtese.  
Pak më rrahu dhe ia mbathi pastaj...  
U familjarizova me fjalën "kuçkë", e s'mbeti çun lagjeje  
qës'ukënaq me trupintimëmallkuar!  
E tëra u shkatërrova! Zemram'ucopëtua.  
Tëvetëvritemdesha, pors'patasukses.  
pasi me barrëmbeta, dhemëdetyruantëabortojë!  
Dhe ja, e sheh, ku përfundova! Këtu, çdo ditë që kalon është ferr,  
vjinë njerëzit më të shpifur (më falni ju).  
Nganjëherë këtej vjen babai me vëllezërit e mi,  
m'i marrin paratë dhe pastaj më përqeshin...  
Kam ndërmend prapë...  
Këtu, e ndërpreva, teksa u visha shpejt. Dhe qava.  
E mora në përaqfim dhe ndala xhazin, i turpëruar skajshëm.  
Ndjejaneverindajvetesdhejetës!  
I kapaduart e bardha, pa thënëasnjëfjalë.  
Teksahënaqengriturmajëmave,  
dhespërkatteqytetin me dritën e saj,  
dolëmdheikëmlargngaai vend i ndyrë...  
Ajo... u bë pjesë e jetës sime.  
Hareja zuri vend tek ne,  
dhe mrekullitë e kësaj bote filluam t'i shijojmë tok.  
Mbrëmjet tona tani gëlojnë nga dashuria e pastër,  
nën dritat e qirinjve dhe tingujve xhaz...  
Dhe fytyra e vetme që Ana sheh mbrëmjeve,  
është fytyra ime...  
Jemi të lumtur!  
Të gjitha vajzave kudo qofshin, u priftë fati i mirë...

Bujar MEHOLLI, 2018

(shkruar në një kafene të Prishtinës)

E jashtëzakonshme

## Dhëndri mbërrin në dasmë me arkivol

Një adoleshente që humbi të dashurin e saj organizoi dasmën dhe funeralin në të njëjtën ditë. Vajza vendosi të martohej me dashurinë e humbur, njëkohësisht t'i thoshte lamtumirë. 19-vjeçarja nga Filipine, e identifikuar vetëm si Zyrine, mbante

veshur një fustan të bardhë, ndërsa dhëndri Jake Anthony Macadangdang erdhi në ceremoni me arkivol të bardhë. Gjatë ceremonisë Zyrine tha premtimet e saj dhe



pastaj vuri një unazë martesë. 22-vjeçari u përplas nga një makinë më 24 gusht.

FOTO E DITES



Një modeluese mban një krijim nga disenjatori Pam Hogg Javën e Londrës gjatë ekspozitës së pranverës së ardhshme 2019. /AP/

E rrallë

## Plastika po vret 40 për qind të breshkave të vogla të detit

Sipas një studimi të ri, lëndët plastike po vrasin 40 për qind të breshkave të vogla të detit. Breshkat e vogla kanë pothuajse katër herë më shumë mundësi të ngordhin nga mbeturinat plastike në krahasim me breshkat e rritura. Sipas analizave në pothuajse 1 000 breshka të



ngordhura, më shumë se gjysma janë këlyshë dhe 1/3 e tyre kanë gëlltitur lëndë plastike, në krahasim me 1/7 tek breshkat e rritura.

## BARSOLETA E DITËS



Gjyqtari pyet të dëmtuarin:  
- Thoni se i akuzuari ju qëllloi me kovë në kokë?  
- Mu në mes.  
- Po në kokën tuaj nuk vërehet asgjë.  
- Ndoshta, por shikojeni kovën si është bërë!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

## “HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation” 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

## “THE DARKEST MINDS”

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

## “THE PREDATOR” 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Jeni të ndjeshëm dhe pak melankolik sot. Kujtime të vjetra ju sjellin nostalgji për vende të caktuara.</p>	 <p><b>DEMI</b> Miq të janë ata që mund t'i vlerësojnë më mirë veprimet tuaja. Mos u mërzisni sot nëse ju kritikojnë në një situatë të caktuar.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Edhe pse eprorët tuaj ju vlerësojnë, përsëri nuk ndiheni të kompensuar nga ana materiale. Mbase është koha të kërkonti një rritje rroge.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot ndiheni shumë mirë sa i përket aspektit të ndjenjave. Diçka e re që sapo ka lindur po ju zë gjithë kohën tuaj dhe mendimet.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot mund të ndiheni të privilegjuar sa iu përket financave dhe do të shpenzoni për një dhuratë personit të dashur.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Jeni shumë të vendosur t'i shkoni deri në fund një projekti personal. Edhe pse nuk do të keni mbështetje, do t'ia dilni mbanë.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Megjithëse energjia nuk ju mungon sot do ta ndieni veten të plogësht. Do ta kërkonti qetësinë dhe rehatinë e shtëpisë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot jeni të përqendruar te çështjet e zemrës. Çdo gjë tjetër do të kalojë në plan të dytë për ju.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Keni dëshirë për gjëra të bukura dhe shoqëri të mirë sot. Do t'ju mjaftonte prania e miqve për të qenë rehat me veten.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot jeni gati për të ikur kudo ku mund të shpëtoni nga streset e ditës. Do ta kërkonti shoqërinë e partnerit sot.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot çdo gjë është fokusuar te financat për ju. Borxhe që do t'ju kthehen dhe shpenzime që nuk i kishit menduar që duhet t'i bëni.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Edhe pse një pjesë e juaja sot i është përkushtuar karrierës, pjesa tjetër do vetëm qetësi dhe të relaksohet. Jeni në dyluftim me veten.</p>



## Gerrardi: Grezda do t'i jap shpejtësinë Rangersit

GLASGOU, 16 SHTATOR - Eros Grezda debutoi të shtunën fanelën e Rangersit ku skuadra e tij fitoi me rezultatin 4-0. Futbollisti i kombëtares shqiptare u aktivizua në minutën e 76 nga trajneri i mirënjohur Stiven Gerrard. Futbollisti u shpreh se

nuk është ende në 100 % të formës së tij. "E di shumë mirë potencialin tim dhe sapo të jem në 100 % atëherë çdo gjë është e mundur. Po punoj që të kap sa më shpejt formën time. Tifozët e Rangersit presin të shohin një lojtar që jep gjithmonë 100 %

nga vetja në fushë pavarësisht se kush është ai. Jam i shpejtë në krahë dhe detyra ime është të jap asistime për shokët, natyrisht edhe të jem sa më pranë portës. Kur erdhi telefonata isha shumë i lumtur", ka thënë Grezda. Edhe trajneri Gerrard ka qenë i

kënaqur nga shqiptari. "Grezda nuk është ende gati. Ai është në 60-70 % të formës dhe ka ende 2-3 javë që i duhet të punojë. Dua një skuadër argëtuese me shpejtësi dhe ritëm. Me siguri që Grezda do të na e japë këtë", ka deklaruar Gerrardi.



## Nishevci i pesti, Karaqi i shtati në 'Berlin 2018'



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Herolind Nishevci ka zënë vendin e pestë në Karate 1 Premierë Ligën "Berlin 2018". Karateisti nga Kosova të dielën humbi luftën për medaljen e bronzit nga kroati Angelo Kvesiq, kategoria +84 kilogramë. Deri tek vendi i pestë, Herolindit iu deshtë t'i mposhtë katër kundërshtarë. Ai kaloi me sukses tre kundërshtarët e parë: Nicola Kaboush (Jordani), Martin Nestorovski (Maqedoni), Raoul Santarelli (Itali), kurse u mund në çerekfinale nga Sajad Ganjzadeh (Iran). Në repesazh mposhti Yaparsan Yapanoglu (Turqi). Nishevci fitoi pikët e para olimpike për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020".

Sukses të madh shënoi edhe Alvin Karaqi, që mposhti tre kundërshtarë: Berat Jakupin (Maqedoni), Zvonimir Zivković (Kroaci), Turgut Hasanov (Azerbajxhan), ndërsa u mposhti në çerekfinale nga Ryutarō Araga (Japoni). Karaqi zuri vendin e shtatë në kategorinë -84 kg. Pikë olimpikë fituan edhe Orges Arifi (-60 kg) dhe Fortesa Orana (+68 kg), që fituan nga një luftë, kurse Elhami Shabani, Gresa Zhitia dhe Adelina Rama, nuk arritën t'i kalojnë kundërshtarët e parë. Premierë Liga "Berlin 2018" ishte gara e parë për pikë olimpikë për karateistët tanë, të cilët i pret një rrugë e gjatë në dy vjetet e ardhshëm.

## Messi: Po më mungojnë Xavi dhe Iniesta



BARCELONË, 16 SHTATOR - Leo Messi është pa dyshim një nga lojtarët më të mirë në historinë e futbollit, por edhe ai ka disa limite në të cilat duhet të punojë më shumë. Argentinasi është i dashuruar me futbollin, e ky nuk përbën lajm. "Shoh gjithçka, sidomos futbollin argentinasi dhe Kupën Libertadores, megjithëse ndonjëherë ndeshjet janë vonë e nuk mundem. Nuk më pëlqen fare t'i shoh ndeshjet e mia, dua të shoh përpara. Kam evoluar si lojtar, por e shoh si diçka normale. Mendoj se pika ku duhet të përmirësohem janë penalltitë". Argentinasi foli edhe për shokët e vet të vjetër

te Barcelona, të vjetër e të rinj, duke theksuar se pa ata, me siguri nuk do të cilësohej si një nga më të mirët në botë: "Xavi dhe Iniesta janë lojtarë të mëdhenj, por jemi ekip i madh dhe pa ta. Kemi ndryshuar disi mënyrën e lojës me largimin e tyre, por nuk do të thotë që jemi më të dobët. Më pëlqen shumë të luaj me Suarezin, ndërkohë Jordi Alba është magjik, kuptohemi me sy". Aktualisht, Leo me Barçën e tij kryesojnë të vetëm La Ligan me pikë të plota në katër ndeshje, pas fitores kundër Real Sociedadit dhe barazimit të Realit të Madridit në fushën e Athletic Bilbaos.

### SHKURT

#### Ozili: Ende nuk kam mbaruar, mos më krahasoni me Berkampin

Mesut Ozili është i vetëdijshëm për krahasimin e bërë me legjendën e Arsenalit, Dennis Berkampin, mirëpo ka thënë se ende ka punë për ta marrë statusin si legjendë e klubit londinez. Berkamp ka qenë pjesë e Arsenalit për nëntë vjet, nga viti 1995 deri më 2006, duke i shënuar 120 gola dhe duke i fituar tre tituj të Premierligës. "Tifozët më kanë përkrahur gjithmonë që prej se kam ardhur këtu para pesë vjetëve dhe, për shkak të kësaj, unë e kam pasur mundësinë të luaj në pozitën time të preferuar. Gjithmonë dua ta kontrolloj ndeshjen, të ofroj asistime dhe ta ndihmoj skuadrën time. Më kanë thënë për shumë vite se kështu ka luajtur edhe Berkampi. Sigurisht kjo më bën të ndihem krenar dhe është një nder që krahasohem me një legjendë si ai, por nuk dua të krahasohem me dikë. Unë kam stilin tim dhe e kam pasur këtë stil që nga fëmijëria. Jam krenar me këto krahasime, mirëpo unë jam Mesut Ozili dhe ende nuk kam mbaruar", ka thënë Ozili.

#### Ronaldo shënon dy gola për Juven

Cristiano Ronaldo ka shënuar dy gola në e fitoren e Juventusit në ndeshjen ndaj Sassolos (2-1). Portugezi golin e parë për "Zonjën e Vjetër" e shënoi në minutën e 50, kurse të dytin në minutën e 65-të. Kouma Babacar e ngushtoi epërsinë e Juvës në fund të ndeshjes për 2-1, kurse në minutat shtesë vendësit luajtën pa një lojtar, pasi Douglas Costa u ndeshua me karton të kuq.

#### Bayernit i kushton shtrenjtë fitorja ndaj Leverkusenit

Fitorja ndaj Bayer Leverkusenit i ka kushtuar shumë skuadrës së Bayern Munchenit, pasi janë lënduar dy lojtarë "bavarezë". Një prej të dëmtuarve ishte Corentin Tolisso, i cili ka pësuar një dëmtim në ligamentet e gjurit të djathtë, gjë që do ta detyrojë atë të qëndrojë jashtë fushave të blerta për disa muaj. Ndërsa Rafinha vuajti pasojat e ndërhyrjes së rëndë të Bellarabit, pikërisht në kavigje, duke i dëmtuar ligamentet, veprim për të cilin u ndëshkua menjëherë me karton të kuq.

#### Ibra realizon golin e 500 në karrierë

Një nga top sulmuesit në botë, Zlatan Ibrahimović, ka realizuar golin e tij 500 në karrierë. Ylli i LA Galaxy shënoi mbrëmë një gol ndaj Torontos kur po luhej minuta e 43-të. Megjithatë, Toronto e fitoi përballjen 5 me 3. Ibrahimović është golashënuesi i dytë më i mirë në MLS, me 17 gola.

#### Hazardi: Giroud është qendërsulmuesi më i mirë në botë

Ylli i Chelsea, Eden Hazard, ka thënë se Oliver Giroud është qendërsulmuesi më i mirë në botë. "Ai është një 'pykë', mbase më i miri në botë. Unë kështu mendoj. Ai mund ta mbajë topin... është kënaqësi të luaj me atë. Kur Alvaro luan, është tërësisht ndryshe, ai është një futbollist krejt ndryshe nga Oliveri. Që të dy kanë cilësi, ndaj jemi të lumtur që kemi sulmues të mirë në ekip", ka thënë Hazardi.

#### Cury, tifoz i Tottenhamit

Ylli i NBA-së dhe Golden State Warriors, Stephen Curry, ka qenë ditën e shtunë në Londër, për ta ndjekur ndeshjen e futbollit në Premierë Ligë mes Tottenhamit dhe Liverpoolit (1-2). Kampioni i NBA-së ka deklaruar së fundi se është një tifoz i skuadrës së Tottenham Hotspurs, që e fitoi për të parë këtë ndeshje dhe para fillimit të saj e ka nderuar me një fanellë speciale të skuadrës, ku ishte shkruar emri i tij. Stephen Curry duket se ka "transferuar" në Premierë Ligë rivalitetin e tij me LeBron James, që zotëron aksione të skuadrës së Liverpoolit. Por duket se nga kjo përballje ka dalë fitues Jamesi, pasi Liverpooli e fitoi këtë ndeshje të zhvilluar në stadiumin "Wembley". Ylli i Warriorsit ndodhet në Evropë prej disa ditësh, teksa të premtën ka qenë edhe në Paris, për ta parë sfidën PSG-Saint Etienne (4-0).



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

**NJOFTIM I PËRGJITHSHËM PËR PROKURIM nr. 2**

**Millennium Foundation Kosovo (MFK)**

Qeveria e Kosovës e ka pranuar një grant për financim prej 49,000,000.00 \$ (*Millennium Challenge Corporation*, MCC) nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara për ta mbështetur Kosovën përmes programit 'Threshold' i cili është projektuar për t'i ulur kostot e energjisë për amvisëritë dhe bizneset dhe për ta mbështetur Qeverinë e Kosovës në përpjekjet e saj për ta përmirësuar transparencën e të dhënave dhe për ta nxitur rritjen ekonomike, për ta luftuar varfërinë dhe për ta avancuar stabilitetin. Për ta zbatuar këtë program dhe për t'i arritur objektivat e grantit të MCC, 'Millennium Foundation Kosovo' (MFK) synon që t'i shfrytëzojë disa pjesë të të ardhurave nga granti për t'i paguar Kontratat për Mallra, Punë dhe Shërbime.

Plani i prokurimit për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm do të përfshijë:

Prokurimet e programit 'Threshold' të Kosovës për periudhën 'shtator 2018 - shtator 2019'

Vlera e përllogarit: 9,085,500 \$

**Prokurimi i mallrave** për Projektin "Reliable Energy Landscape", Projektin "Transparent and Accountable Governance Project" (Qeverisja transparente dhe e përgjegjshme) dhe për sektorët e përgjithshëm të Administratës së MFK përfshinë:

- Furnizimin dhe instalimin e stacioneve të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit (MCA) - pajisje të reja për 7 stacione ekzistuese - Aktiviteti për të Dhënat Mjedisore
- Furnizimin dhe instalimin e komunikimit për 12 stacione për MCA - Aktiviteti për të Dhënat Mjedisore

**Prokurimi i punëve** për Projektin "Reliable Energy Landscape", Projektin "Transparent and Accountable Governance Project" (Qeverisja transparente dhe e përgjegjshme) dhe për sektorët e përgjithshëm të Administratës së MFK përfshinë:

- AER - Punët nën aktivitetin për retrofitet për efikasitet në banesat kolektive.
- Masat e efikasitetit të energjisë për zyrat e reja

**Prokurimi i shërbimeve (përfshirë shërbimet e konsulentëve)** për Projektin "Reliable Energy Landscape" Projektin "Transparent and Accountable Governance Project" (Qeverisja transparente dhe e përgjegjshme) dhe për sektorët e përgjithshëm të Administratës së MFK përfshinë:

- Konsulentin për zbatim të menaxhimit të 'Pilotimit të stimujve për aktivitete në Efikasitetin e Energjisë' (PSEE)
- Konsulentin për zbatim të aktivitetit 'Njehsimi i ngrohjes qendrore' (NjNjQ)
- Mbikëqyrjen e shërbimeve të konsulentëve për PSEE dhe NjNjQ
- Partnerin implementues për Aktivitetin Mjedisor
- Menaxhimin e organizimit për 'Environment Open Data Challenge' (Sfida e hapur e të dhënave mjedisore)
- Menaxhimin e organizimit të 5 punëtorëve (3 ODC për Punë dhe 2 ODC për Mjedis)
- Komunikimin dhe informimin në terren (LFTUS ODC përfshinë edhe ceremoninë e fillimit dhe të mbylljes)
- Menaxhimin e organizimeve të seminareve CMIS dhe për aktivitetet promovuese
- Shërbimet e auditimit
- Shërbimet e përkthimit dhe të interpretimit
- Konsulentët e trajnimeve për punëtorët ODC për Mjedis
- Konsulentët e trajnimeve (3) për punëtorët për të dhënat (3)
- Konsulentin për Kontrollin e Cilësisë dhe Këshillimin për të Dhënat e Hapura të ASK-së
- Konsulentët - Juria për 'Open Data Challenge'
- Konsulentin për punë përgatitore për zhvillimin e CMIS dhe TeR
- Analistin për monitorim dhe vlerësim
- Konsulentin për Programin e Praktikës në RELP
- Konsulentin për mbështetje për Programin e Ministrisë për Praktikë në RELP
- Konsulentin junior për Programin e Praktikës në RELP
- Menaxherin e grantit - për projektin 'Kosovo Open Data Challenge Support' (Mbështetje për sfidën e të dhënave të hapura në Kosovë)
- Konsulent për dizajnimin e 'Web Portal'-it
- Sigurimi për zyrat

Kontratat për Mallrat, Punët dhe Shërbimet e financuara nga programi do të zbatohen sipas parimeve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzimet e Prokurimit të Programit të MCC të cilat mund të gjenden në faqen e internetit të MCC.

Prokurimet janë të hapura për të gjithë ofertuesit nga vendet burimore të pranueshme, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit të Programit të MCC.

Njoftimet specifike të prokurimit për kontratat që do të tenderohen për mallra, shërbime te konsulencës dhe punë do të shpallen, pasi që të bëhen të disponueshme, në faqen e internetit të MFK (MFK: <http://millenniumkosovo.org/>), United Nations Development Business (UNDB: <http://www.devbusiness.com/>), (DgMarket: <http://www.dgmarket.com/>), në gazetën vendase dhe në media të tjera, sipas rastit.

Kontraktuesit dhe konsulentët e interesuar të pranueshëm që dëshirojnë të përfshihen në listën e shpërndarjes së njoftimeve specifike ose ata që kërkojnë informacione shtesë, duhet ta kontaktojnë: [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org)

Millennium Foundation Kosovo  
Rr. Johan V. Hahn, nr.11,  
Prishtinë 10000,  
Kosovë  
Telefoni: +383 38 200 14 315

Adresa: Rruga Johan v. Hahn, no.1|10000 Prishtina, Kosovo |Tel: +383 3820014315



REPUBLIKA KOSOVO

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

**OPËSTE OBAVEËSTENJE O NABAVCI br. 2**

**Millennium Foundation Kosovo (MFK)**

Vlada Kosova je dobila grant u iznosu od 49.000.000,00 USD (četrdeset devet miliona američkih dolara) od korporacije Millennium Challenge Corporation (MCC) Vlade Sjedinjenih Američkih Država kao podršku Kosovu kroz Program prag, a koji je osmišljen tako da smanji troškove domaćinstava i privrednih subjekata za energiju i da podrži Vladu Kosova u njenim naporima da unapredi transparentnost podataka radi podsticanja rasta, suzbijanja siromaštva i unapređenja stabilnosti. Fondacija Millennium Foundation Kosovo (MFK) koja realizuje ovaj program i radi na postizanju ciljeva granta MCC-a, namerava da deo sredstava izdvoji za ugovore za robu, radove i usluge.

Program nabavke za narednih dvanaest meseci obuhvatiće sledeće:

Kosovo THP nabavka za septembar 2018 – septembar 2019.

Procenjena vrednost: 9.085.500 USD

**Nabavka robe** u sklopu Projekta pouzdanog energetskog prizora, Projekta transparentnog i odgovornog upravljanja i opštih sektora uprave MFK-a obuhvata:

- Nabavku i ugradnju stanica za praćenje kvaliteta vazduha - nova oprema za 7 postojećih stanica - Aktivnost ekoloških podataka
- Nabavka i ugradnja komunikacije za 12 stanica za PKV - Aktivnost ekoloških podataka

**Nabavka radova** u sklopu Projekta pouzdanog energetskog prizora, Projekta transparentnog i odgovornog upravljanja i opštih sektora uprave MFK-a obuhvata:

- ARE - Adaptacija stambene zgrade radi efikasnosti, radovi u sklopu podaktivnosti
- Mere energetske efikasnosti za nove kancelarije

**Nabavka usluga (uključujući usluge konsultanata)** u sklopu Projekta pouzdanog energetskog prizora, Projekta transparentnog i odgovornog upravljanja i opštih sektora uprave MFK-a obuhvata

- Angažovanje konsultanta za upravljanje Probnim podsticajem za aktivnost energetske efikasnosti u domaćinstvu
- Angažovanje konsultanta za aktivnost merenja potrošnje centralnog grejanja
- Nadzorne konsultantske usluge za PPEE i MPCG
- Angažovanje partnera za aktivnost životne sredine
- Upravljanje događajem za konkurs za otvorene podatke u oblasti životne sredine
- Upravljanje događajem za 5 radionica (3 KOP za rad i 2 za KOP za životnu sredinu)
- Komunikacija i informisanje (LFTUS KOP obuhvata i svečanost puštanja u rad i svečanost zatvaranja)
- Upravljanje događajem za radionice za CMIS i promotivne aktivnosti
- Usluge revizije
- Usluge usmenog i pismenog prevodenja
- Obuka konsultanata za KOP za radionice za životnu sredinu
- Obuka konsultanata (3) za radionice za podatke (3)
- Konsultant za kontrolu kvaliteta i savete o otvorenim podacima za KAS
- Konsultanti - Žiri za konkurs za otvorene podatke
- Konsultant za pripremu rad na razvoju CMIS-a i OZ
- Analičar za monitoring i evaluaciju
- Konsultant za program stažiranja u PPEP
- Konsultant, Podrška Ministarstvu za program stažiranja u PPEP
- Mlađi konsultant za program stažiranja u PPEP
- Upravnik granta - za projekat Podrška konkursu za otvorene podatke na Kosovu
- Konsultant za izradu internet portala
- Osiguranje službenih prostorija

Ugovori za robu, radove i usluge finansirani u sklopu programa realizovaće se u skladu sa načelima, pravilima i postupcima utvrđenim u Smernicama za nabavku MCC-ovog Programa, a koje se mogu pronaći na internet portalu MCC-a.

Nabavka je otvorena svim ponuđačima iz kvalifikovanih zemalja, prema definiciji iz Smernica za nabavku MCC-ovog Programa.

Posebna obaveštenja za nabavku za ugovore koji se stave na javni poziv u okviru postupka za konkurs za dostavljanje ponuda i za ugovore za konsultante biće objavljena po potrebi, na internet portalu MFK-a (MFK: <http://millenniumkosovo.org/>), portalu Ujedinjenih nacija za razvoj poslovanja (UNDB: <http://www.devbusiness.com/>), portalu Development Gateway Market (dgMarket: <http://www.dgmarket.com/>), u lokalnoj štampi i drugim medijskim kućama, po mogućstvu.

Zainteresovani, kvalifikovani izvođači radova i konsultanti, koji žele da budu stavljeni na spisak za slanje pošte sa primerkom oglasa, ili koji žele dodatne informacije, mogu se obratiti putem sledeće adrese:

[procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org)

Millennium Foundation Kosovo  
Ul. Johan V. Hahn, br. 11,  
Priština 10000,  
Kosovo  
Telefon: +383 38 200 14 315

Adresa: Ul. Johan v. Hahn, br.1|10000 Priština, Kosovo |Tel: +383 3820014315



## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

### Njoftim Mbi anulimin e konkursit:

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallë njoftimin për anulimin e konkursit të publikuar më datën 14.09.2018 në gjuhen shqipe dhe serbe, për vendin e punës: Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional me nr. Referencës DR/470/JP00034258.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

### Obaveštenje o poništavanju konkursa:

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, objavljuje obaveštenje o poništavanju konkursa raspisan dana 14.09.2018.godine na albanskom i srpskom jetiku, za radno mesto: Viši službenik za stručnu saradnju br Reference DR/470/JP00034258.

Hvala na razumevanju!




### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Arbenita Zeneli e lindur me dt,09.05.1995 në Mitrovicë me nr.personal 1234741183, shpall te pa vlefshme Certifikatën e gjendjes martesore nr 11/2010RL/11001, dhe nr. rëndor 1166 të lëshuar me dt: 20.06.2018 nga ana e Komunës se Mitrovicës.
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m<sup>2</sup>. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

**Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.**

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Republika e Kosovës /  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

KPK / Nr. 399 / 2018  
Datë: 7 shtator 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 11 të Rregullores Nr.02/2015 për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 7 shtator 2018 - KPK / Nr. 369 / 2018, shpall:

**KONKURS PUBLIK  
(RISHPALLJE)**

**Për pozitën e Anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile**

I. Kandidatët e nominuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:




1. Të jenë shtetas dhe banor të Republikës së Kosovës;
2. Të kenë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
3. Të kenë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
4. Të kenë përvojë pune në çështjet ligjore prej pesë (5) vjetësh;
5. Të jenë të paanshëm politikisht për të paktën tre (3) vjetët e fundit;
6. Të kenë përkrahjen e së paku pesë (5) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
7. Të mos jenë të dënuar për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes, siç përkufizohet me ligj;

II. Shoqëria civile duhet t'ia bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati plotëson kushtet e paraqitura me këtë shpallje publike.

III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon shoqërinë civile që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të Këshillit, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

IV. Konkursi do të jetë i hapur nga data 17.09.2018 deri më 01.10.2018.

V. Propozimet dhe dokumentet shtesë duhet të dërgohen të mbyllura në zarf në katin e pestë (5) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj", Prishtinë, zyra numër 504.

**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

TSK / Br.399/2018  
Datum: 7 Shtetor 2018

Tužilački Savet Kosova, na osnovu člana 3 stav 2.3 Zakona Br.05/L-035 o Izmenama i Dopunama Zakona Br.03/L-0224 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu člana 11 Pravilnika Br. 02/2015 o Izboru Članova Tužilačkog Saveta Kosova i na osnovu Odluke Tužilačkog Saveta Kosova dana 7 septembra 2018- TSK Br.369/2018, raspisuje:

**JAVNI KONKURS  
(PONOVA OBJAVA)**

**Za položaj člana Tužilačkog Saveta Kosova iz redova civilnog društva.**

I. Predloženi kandidati za položaj člana Tužilačkog Saveta Kosova iz redova civilnog društva treba ispunjavati sledeće kriterijume:

1. Da budu državljan i stanovnici Republike Kosova;
2. Da imaju visoku stručnu spremu iz oblasti pravosuđa;
3. Da imaju znanja iz oblasti ljudskih prava;
4. Da imaju radno iskustvo na pravna pitanja od pet (5) godina;
5. Politički nepristrasan najmanje u poslednje tri (3) godine;
6. Da imaju podršku od najmanje pet (5) organizacija civilnog društva iz pravosudne oblasti;
7. Da ne budu osuđeni za krivično delo, izuzev prekršajnih kao što je definisano zakonom;

II. Civilno društvo listi nominovanih kandidata za članove Tužilačkog Saveta Kosova, treba priložiti i dokumente koji potvrđuju da kandidat ispunjava uslove koji su postavljeni ovim javnim konkursom.

III. Tužilački Savet Kosova, ohrabruje civilno društvo da tokom dostavljanja predloga za člana Saveta, uzima u obzir multietnički sastav Republike Kosova i priznata načela rodne ravnopravnosti.

IV. Konkurs biće otvoren od 17.09.2018 do 01.10.2018.

V. Predloge i dodatne dokumente treba poslati na petom (5) spratu zgrade Državnog Tužioca, ulica Luan Haradinaj – Priština, kancelarija broj 504, u zatvorenoj kovčetu.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

